

# Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi ekonomik në Kosovë

Marija Milenković, Jovana Jakovljević, Vesela Vlašković, Dragiša Mijačić



**Mbeturinat komunale**

**Pyjet**

**Bujqësia**

**Ujërat**



Projekti të cilin e financon BE-ja e udhëheqë zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Zbaton:



**Botoi:**

Instituti për zhvillim ekonomik territorial (InTER)

**Për botuesin:**

Dragisha Mijaçiq

**Autorët:**

Marija Millenković  
Jovana Jakovleviq  
Vesella Vllashković  
Dragisha Mijaçiq

**Viti:**

2017

VËREJTJE: Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e InTER dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

## **Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi ekonomik në Kosovë**

**2017**

**PËRMBAJTJA:**

|   |           |
|---|-----------|
| <b>LISTA E SHKURTESAVE</b>  | <b>1</b>  |
| <b>1 HYRJE</b>  | <b>2</b>  |
| <b>2 MENAXHIMI I MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË: MUNDËSI PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK APO KËRCËNIM PËR TË?</b> | <b>4</b>  |
| 2.1 HYRJE   | 4         |
| 2.2 KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE  | 4         |
| 2.3 MENAXHIMI I MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË  | 5         |
| 2.4 PROBLEMET NË MENAXHIMIN E MBETURINAVE KOMUNALE DHE NDIKIMI NË ZHVILLIM EKONOMIK                       | 8         |
| 2.5 PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIMET   | 10        |
| <b>3 PYJET NË KOSOVË – NJË PASURI QË PO ZHDUKET</b>   | <b>13</b> |
| 3.1 HYRJE   | 13        |
| 3.2 LEGJISLACIONI DHE INSTITUCIONET   | 13        |
| 3.3 GJENDJA AKTUALE NË PYLLTARI DHE NDIKIMI NË MJEDIS   | 15        |
| 3.4 PYLLTARIA NË KOSOVË – POTENCIALI PËR ZHVILLIM EKONOMIK?   | 17        |
| 3.5 PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIMET   | 18        |
| <b>4 ZHVILLIMI I BUJQËSISË NË KOSOVË DHE NDIKIMI I SAJ NË MJEDIS</b>                                      | <b>20</b> |
| 4.1 HYRJE   | 20        |
| 4.2 KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE  | 20        |
| 4.3 GJENDJA E BUJQËSISË NË KOSOVË DHE NDIKIMI I SAJ NË MJEDIS   | 25        |
| 4.4 PËRSE BUJQËSIA (NUK) PËRBËN MUNDËSI ZHVILLIMI PËR VERIUT TË KOSOVËS?                                  | 29        |
| 4.5 PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET  | 32        |
| <b>5 UJËRAT NË KOSOVË</b>   | <b>35</b> |
| 5.1 HYRJE   | 35        |
| 5.2 KORNIZA LIGJORE DHE LEGJISLATIVE  | 35        |
| 5.3 GJENDJA AKTUALE NË SEKTORIN E UJËRAVE   | 38        |
| 5.4 NDOTJA E RESURSEVE UJORE  | 42        |
| <b>PËRFUNDIMI</b>   | <b>47</b> |

## LISTA E SHKURTESAVE

|               |   |
|---------------|---|
| <b>ADA</b>    | Austrian Development Agency                                   |
| <b>AZHB</b>   | Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë                           |
| <b>CEFTA</b>  | Central European Free Trade Agreement                         |
| <b>DANIDA</b> | Danish International Development Agency                       |
| <b>BE</b>     | Bashkimi Evropian   |
| <b>EURED</b>  | European Union Regional Economic Development                  |
| <b>FAO</b>    | Food and Agriculture Organization of the United Nations       |
| <b>SG</b>     | Skema e granteve  |
| <b>INTER</b>  | Instituti për zhvillim ekonomik territorial                   |
| <b>IOM</b>    | International Organization for Migration                      |
| <b>IPA</b>    | Instrument for Pre-Accession Assistance                       |
| <b>IPARD</b>  | Instrument for Pre-Accession Assistance for Rural Development |
| <b>JICA</b>   | Japan International Cooperation Agency                        |
| <b>KEK</b>    | Korporata Energjetike e Kosovës                               |
| <b>MAPL</b>   | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal                  |
| <b>MIE</b>    | Ministria e Integritimit Evropian                             |
| <b>MZHE</b>   | Ministria e Zhvillimit Ekonomik                               |
| <b>MF</b>     | Ministria e Financave   |
| <b>MBPZHR</b> | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural        |
| <b>MPJ</b>    | Ministria e Punëve të Jashtme                                 |
| <b>MPB</b>    | Ministria e Punëve të Brendshme                               |
| <b>MSH</b>    | Ministria e Shëndetësisë                                      |
| <b>MMPH</b>   | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor               |
| <b>REC</b>    | Regional Environment Centar                                   |
| <b>SIDA</b>   | Swedish International Development Cooperation Agency          |
| <b>UNDP</b>   | United Nations Development Programme                          |
| <b>USAID</b>  | United States Agency for International Development            |

## 1 HYRJE

Mbrojtja e mjedisit është një nga aktualitetet më të rëndësishme të shoqërisë moderne, e ndërlidhur ngushtë me zhvillimin socio-ekonomik, cilësinë e jetës dhe prosperitetin e gjeneratave të ardhshme.

Rritja e numrit të banorëve dhe zhvillimi i industrisë ka rezultuar me rrezikim të natyrës që na rrethon, prandaj nevoja për të mbrojtur mjedisin është shndërruar në një fenomen që kërkon përgjigje në nivel global. Si rrjedhojë, politikat e fushës së mbrojtjes së mjedisit janë shumëshiresore, ndërsa numri i institucioneve që implementojnë apo përcjellin implementimin e dispozitave nga kjo fushë rritet deri në atë masë sa që veprimi i tyre kërkon resurse të konsiderueshme të cilat shpesh tejkalojnë kornizat buxhetore në dispozicion për to, në veçanti tek vendet në zhvillim.

Edhe pse çështjet që ndërlidhen me mjedisin në Kosovë nuk janë të ranguar lartë në listën e prioriteteve politike dhe zhvillimore, Qeveria e Kosovës, përkitazi me mundësitë dhe kapacitetet e veta, përpiqet që të harmonizojë legjislacionin e vendit me rregullativën globale e evropiane. Së këndejmi, janë miratuar dhjetëra ligje, akte nënligjore, strategji dhe programe që rregullojnë segmente të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, ndërsa janë formuar edhe institucione të shumta të cilat drejtpërsëdrejti implementojnë apo përcjellin implementimin e rregullativës nga kjo fushë.

Mbrojtja e mjedisit ndikon edhe në ekonomi, para së gjithash në domenin e zbatimit të rregullativës komplekse ligjore, gjë që patjetër paraqet ngarkesë për veprimtarinë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, e në veçanti veprimtarinë e ndërmarrjeve të sapoformuara. Në anën tjetër, implementimi i politikave publike nga fusha e mjedisit gjithashtu i hapë mundësi valorizimit ekonomik në kuptim të zhvillimit të sektorit privat dhe hapjes së vendeve të reja të punës.

Marrë parasysh faktin se ndërmarrësit, autoritetet lokale dhe qytetarët në përgjithësi nuk kanë njohuri të mjaftueshme lidhur me rregullativën nga fusha e mjedisit, e kjo është veçanërisht e vërtetë për veriun e Kosovës ku njohuria mbi legjislacionin e Kosovës është në nivel të ulët sidoqoftë, Instituti për Zhvillim Ekonomik Territorial (InTER) e ka inicuar projektin “Dialogu për politikat publike dhe aktivitetet zhvillimore për mbrojtje më të mirë të mjedisit”, me qëllim të nxitjes së diskutimit dhe afirmimit të kësaj teme në shoqëri.

Projekti filloi në janar të vitit 2016, me përkrahje financiare nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, ndërsa ka zgjatur deri në qershor të vitit 2017. Nën kornizën e këtij projekti janë trajtuar katër tema të rëndësishme për mjedisin, përfshirë: menaxhimin e mbeturinave komunale, mbrojtjen e pyjeve, bujqësinë dhe mbrojtjen e ujërave dhe resurseve ujore. Nën kornizën e secilës prej këtyre temave janë hartuar hulumtime të shkurtra të politikave publike, janë organizuar debate publike me akterë relevantë dhe janë iniciuar fushata mediatike mbi sfidat kyçe nga fusha e mbrojtjes së mjedisit.

Në fund të projektit është organizuar një konferencë profesionale që ka grumbulluar të gjithë akterët relevantë nga niveli qendror dhe lokal, përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, organizatave joqeveritare, universiteteve dhe organizatave ekonomike, me të cilët është diskutuar për rezultatet e hulumtimit dhe problemet tjera dhe sfidat e hasura në fushat e trajtuara. Përfundimet nga konferenca janë sublimuar në rezultatet paraprake të hulumtimeve dhe janë paraqitur në formë të këtij studimi të cilin e keni para vetes.

## **2 MENAXHIMI I MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË: MUNDËSI PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK APO KËRCËNIM PËR TË?**

### **2.1 Hyrje**

Grumbullimi dhe deponimi joadekuat i mbeturinave në Kosovë çdo vit i kushton vendit mes 19 dhe 31 milionë euro.<sup>1</sup> Ky fakt e bën të qartë se janë të domosdoshme masat për krijimin e një sistemi efikas të menaxhimit të mbeturinave, si për ta përmirësuar gjendjen e gjithmbarshme të mjedisit, ashtu edhe për të ngritur mundësitë e shfrytëzimit të mbeturinave për qëllime të zhvillimit ekonomik.

Menaxhimi i mbeturinave komunale është proces kompleks që përfshin aktivitetet e grumbullimit, transportimit, reciklimit, rishfrytëzimit, trajtimit dhe deponimit të mbeturinave komunale. Kurrsesi nuk guxon të neglizhohet fakti që çdo mbeturinë përbën edhe resurs potencial e jo vetëm problem ekologjik. Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi ekonomik mund të avancohen bashkërisht, ndërsa politikat publike në këtë fushë luajnë rol kyç për krijimin e vendeve të punës dhe stimulimin e investimeve. “Gjelbërimi i ekonomisë”<sup>2</sup> zvogëlon shpenzimet e mbrojtjes së mjedisit përmes shfrytëzimit më efikas të resurseve, ndërsa përdorimi i teknologjive të pastra i kontribuon hapjes së vendeve të reja të punës dhe përbën stimul për ekonominë dhe zhvillimin e konkurrencës.

Kjo analizë e shkurtër ofron një pasqyrë të situatës aktuale në fushën e menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë, duke shqyrtuar në veçanti gjendjen në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës (Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok dhe Zveçan). Gjithashtu, me këtë punim analizohet edhe korniza ligjore në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe lidhshmëria e kësaj sfere me zhvillimin ekonomik lokal.

### **2.2 Korniza ligjore dhe institucionale**

Në disa vitet e fundit janë miratuar disa akte ligjore dhe nënligjore dhe dokumente strategjike me të cilat rregullohet korniza ligjore për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë. Ligji për Mbeturinat Nr. 03/L-060<sup>3</sup> paraqet aktin themelor që i përcakton parimet kryesore në lidhje me menaxhimin e mbeturinave, si dhe përgjegjësitë dhe kompetencat e institucioneve relevante. Me sektorin e mbeturinave janë ngushtë të ndërlidhur edhe Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit,<sup>4</sup> Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor<sup>5</sup> Ligji për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor,<sup>6</sup> Ligji për Parandalimin e Integruar dhe Kontrollin e Ndotjes,<sup>7</sup> Ligji për Inspektoratin e Mjedisit,

<sup>1</sup> Analiza Mjedimore e Kosovës (2013), Banka Botërore, e qasshme në adresën: <http://bit.ly/2jxiD03>, f. 47.

<sup>2</sup> Ekonomia e gjelbër është term që nënkupton shfrytëzimin e gjerë të burimeve të ripërtëritshme për energji, ngritjen e eficiencës së energjisë, si dhe zhvillimin dhe aplikimin e bujqësisë organike të qëndrueshme.

<sup>3</sup> Ligji për Mbeturinat, Nr. 04/L-060, i qasshëm në adresën: <http://bit.ly/2iJ8wkh>

<sup>4</sup> Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Nr. 03/L-025, i qasshëm në adresën: <http://bit.ly/2k0hcnt>

<sup>5</sup> Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Nr. 03/L-230, i qasshëm në adresën: <http://bit.ly/2j9a9sr>

<sup>6</sup> Ligji për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor, Nr. 03/L-024, i qasshëm në adresën: <http://bit.ly/2jKZtRE>

<sup>7</sup> Ligji për Parandalimin e Integruar dhe Kontrollin e Ndotjes, Nr. 03/L-043, i qasshëm në adresën: <http://bit.ly/2iBzS0y>



Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit,<sup>8</sup> Ligji për Kimikatet,<sup>9</sup> Ligji për Planifikimin Hapësinor<sup>10</sup>, etj.

Sipas Ligjit për Mbeturinat, menaxhimi i mbeturinave përfshin disa prioritete: parandalimi i krijimit të mbeturinave dhe zvogëlimi i sasisë së mbeturinave, trajtimi i mbeturinave, reciklimi i mbeturinave, shfrytëzimi dhe deponimi i mbeturinave. Nenet 8, 9 dhe 10 të Ligjit për Mbeturinat përcaktojnë obligimin e hartimit të Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave, Planit Kombëtar për Menaxhim të Mbeturinave, Planit Komunal për Menaxhim të Mbeturinave, Planit për Menaxhimin e Mbeturinave nga Prodhuesit e Mbeturinave dhe Planit për Menaxhimin e Mbeturinave nga Personat e Licencuar.

Strategjia e menaxhimit të mbeturinave është përgatitur për periudhën 2013-2022 dhe paraqet një dokument bazik në të cilin janë definuar objektivat dhe masat për përmirësimin e situatës në kuptim të menaxhimit të mbeturinave. Plani kombëtar i veprimit për menaxhim të mbeturinave është hartuar për periudhën 2013-2017 dhe ka për qëllim zvogëlimin e sasisë së mbeturinave dhe shmangien e rreziqeve që mund të rrjedhin nga to, rishfrytëzimin dhe trajtimin e tyre dhe zvogëlimin e ndotjes, në pajtim me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian. Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave është pjesë e Planit Ekologjik Lokal (PEL). Falë ndihmës së ofruar nga Qendra Rajonale Mjedisore (REC), gjatë vitit 2016 PEL janë hartuar në të katër komunat e lartpërmendura (Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok dhe Zveçan).

Përveç kornizës legjislative, nga viti 2000 është punuar edhe në vendosjen e strukturave administrative për avancimin e mjedisit në Kosovë. Ministria për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Planifikimin Hapësinor (MMPH) është institucioni qendror përgjegjës për fushën e mjedisit. Agjencia e Kosovës për Mbrojtje të Mjedisit është themeluar në vitin 2006 nën ombrellën e MMPH-së dhe është përgjegjëse për krijimin e një sistemi informativ për menaxhimin e mbeturinave dhe për përpilimin e raporteve për gjendjen e mjedisit. Në nivelin lokal, komunat bartin kompetenca për mbrojtjen e mjedisit dhe trajtimin e mbeturinave. Në komunat në veri të Kosovës nuk ekzistojnë drejtori të veçanta që merren me çështjen e mjedisit, ndërsa punët nga kjo fushë i kryen zyrtari për mjedisin i cili është i sistemuar në drejtori tjera (kryesisht në drejtoritë për urbanizëm, shërbime komunale, etj.) nën sistemin e Republikës së Serbisë. Në Kosovë janë themeluar edhe struktura tjera përcjellëse për mbrojtjen e mjedisit, siç janë agjencitë, këshillat, komisionet, të cilat funksionojnë ose në mënyrë të pavarur ose brenda kornizave të ministrive të ndryshme.

### **2.3 Menaxhimi i mbeturinave komunale në Kosovë**

Menaxhimi i mbeturinave komunale në Kosovë paraqet sfida të madhe. Niveli i ulët i implementimit të ligjit dhe mungesa e kapaciteteve administrative në nivel lokal në këtë fushë, si dhe mungesa e mjeteve infrastrukturore dhe financiare, përbëjnë problemet kryesore me të cilat përballen autoritetet lokale, por edhe subjektet ekonomike të cilat merren me këtë

<sup>8</sup> Ligji për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, Nr. 04/L-175, i qasshëm në adresën: <http://bit.ly/2k0arBV>

<sup>9</sup> Ligji për Kimikatet, Nr. 04/L-197, i qasshëm në adresën: <http://bit.ly/2iRgrzb>

<sup>10</sup> Ligji për Planifikimit Hapësinor, Nr. 04/L-174, i qasshëm në adresën: <http://bit.ly/2jzlwgu>

veprimtari. Në Raportin e Progresit të Kosovës gjatë vitit 2016, të hartuar nga Komisioni Evropian, është theksuar se mundësitë e përfshirjes së sektorit privat në këtë fushë janë të limituara, sepse konceptet themelore të menaxhimit të mbeturinave dhe veprimet e caktuara, siç janë riciklimi dhe rishfrytëzimi i mbeturinave të ndryshme, nuk përkrahen sa duhet në legjislacionin ekzistues.<sup>11</sup> Aktualisht, legjislacioni i BE që mbulon mjedisin përbëhet nga 802 akte,<sup>12</sup> ndërsa rreth 60% e *Acquis* të BE në këtë fushë veç është inkorporuar në legjislacionin e Kosovës<sup>13</sup> Sa i përket legjislacionit horizontal, Direktiva 85/337/EEC për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe Direktiva 2001/42/EC për vlerësimin strategjik mjedisor janë në harmoni të plotë me kornizën legjislativë lokale, ndërsa në rastin e Direktivës 2003/35/EC për pjesëmarrje të publikut harmonizimi është i pjesshëm.<sup>14</sup> Nëse vlerësojmë legjislacionin në fushën e mbeturinave, Ligji për Mbeturinat është pothuajse tërësisht i harmonizuar me Direktivën 2008/98/EC për Mbeturinat dhe Direktivën 1999/31/EC për Deponitë. Megjithatë, harmonizimi me disa direktiva tjera të kësaj sfere vazhdon të mos jetë i plotë,<sup>15</sup> ndërsa prioritet për vitin tjetër do të jetë hartimi i ligjeve të reja dhe amandamentimi i ligjeve aktuale për ta përafuar legjislacionin e vendit me *Acquis Communautaire* të BE-së.

Edhe pse zvogëlimi i sasisë së mbeturinave komunale është një nga caqet strategjike të Republikës së Kosovës, në realitet kemi rritje të konstante të sasisë së tyre. Në krahasim me vitin 2007 kur mesatarisht në ditë është grumbulluar 0.5 kg mbeturina komunale për kokë banori, në vitin 2013 sasia ka qenë pothuajse dy herë më e lartë (0.9 kg për kokë banori).<sup>16</sup> Nuk ka të dhëna të qëndrueshme mbi sasinë e mbeturinave komunale në veri të Kosovës, por mund të supozohet që trendi në to është i ngjashëm me atë të pjesës tjetër të saj.

Në komunat në veri të Kosovës menaxhimi i mbeturinave është organizuar përmes ndërmarrjeve komunale publike të cilat janë themeluar nga autoritetet lokale para vitit 1999. Subjektiviteti juridik i tyre është mbajtur brenda sistemit juridik të Republikës së Serbisë i cili është i pranishëm në këto komuna. Në komunat tjera të Kosovës, ndërmarrjet komunale publike kanë ndërprerë veprimtarinë e tyre pas vitit 1999, ndërsa me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare është krijuar një sistem në të cilin menaxhimi i mbeturinave është organizuar përmes partneriteteve publiko-private.

Në Kosovë nuk ka infrastrukturë të zhvilluar për deponimin dhe trajtimin e mbeturinave komunale, që ka rezultuar me paraqitjen e një numri të madh të deponive joligjore. Përveç kësaj, ekziston problemi i krijimit të deponive joformale, në veçanti nëpër fshatra dhe zona rurale në të cilat nuk ekziston sistemi i organizuar i grumbullimit të mbeturinave nga ana e institucioneve kompetente apo koncesionarëve të tyre. Sa i përket komunave të veriut të Kosovës, situata sa i përket menaxhimit të mbeturinave komunale në Zveçan, Leposaviq dhe

<sup>11</sup> Komisioni Evropian, Raporti i vitit 2016 për Kosovën\*, i qasshëm në adresën: <http://bit.ly/2jzj89G>, f. 56.

<sup>12</sup> ETNAR: Instrumentet ligjore për mbrojtjen e mjedisit, i qasshëm në adresën: <http://bit.ly/2jo41hb>

<sup>13</sup> Agjencia Mjedisore Evropiane, Raporti i Gjendjes së Mjedisit në Kosovë\*, i qasshëm në adresën: <http://bit.ly/2j9nMIr>

<sup>14</sup> Programi kombëtar për Implementimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, Prishtinë, mars 2016., i qasshëm në adresën: <http://bit.ly/2rUMofF> f. 323.

<sup>15</sup> Direktiva 2004/35/EC për Përgjegjësitë për Dëmet Ekologjike, Direktiva 2008/99/EC për Mbrojtjen e Mjedisit Përmes së Drejtës Penale, Direktiva 2006/21/EC për Menaxhimin e Mbeturinave Industriale, Direktiva 2003/4/EC për Qasje në Informata, etj.

<sup>16</sup> Agjencia për Statistika e Kosovës – Hulumtimi për Mbeturinat Komunale 2007-2013.

Mitrovicë të Veriut është përkeqësuar dukshëm nga viti 2012, pas mbylljes së deponisë Ballaban. Zubin Potoku është e vetmja komunë e cila aktualisht ka deponi funksionale në të cilën deponohen edhe mbeturinat nga Mitrovica e Veriut. Komunitat tjera mbeturinat i deponojnë në deponi të përkohshme ilegale.

Me qëllim të zgjidhjes së problemit të mbeturinave, Bashkimi Evropian i ka ndarë 5.4 milionë euro nga shuma e gjithmbarshme prej 38.4 milionë euro që e ka destinuar për komunitat e veriut të Kosovës për ndërtimin e deponisë së re rajonale “Stena e Savës” brenda territorit të komunës së Zveçanit. Kontrata për shfrytëzimin e deponisë rajonale është nënshkruar nga të katër komunitat e veriut të Kosovës, megjithëse Zubin Potoku nuk do t’i deponojë aty mbeturinat për shkak të shpenzimeve të mëdha të transportit.<sup>17</sup> Ndërtimi i deponisë rajonale ende nuk ka filluar, por janë në zhvillim e sipër punët përgatitore që ndërlidhen me hartimin e dokumentacionit projektues-teknik dhe shpronësimin e tokës. Problem i veçantë përbën shpronësimi i 24 parcelave në pronë private në vendin ku duhet të ndërtohet rruga për t’iu qasur deponisë rajonale. Me zgjidhjen e këtyre problemeve po merret administrata lokale e komunës së Zveçanit.

Deponia rajonale do të funksionojë nën kornizat e legjislacionit të Kosovës. Është planifikuar që dy vitet e para deponia të menaxhohet nga një ekip i përzgjedhur nga Komisioni Evropian e më pas menaxhimi t’i kalojë komunës së Zveçanit. Është paraparë hapja e rreth 80 vendeve të reja të punës në deponi, kryesisht në punët që ndërlidhen me ndarjen e mbeturinave, gllabërimin e gazit natyror që lëshohet gjatë procesit të deponimit dhe punët lidhur me përpunimin e ujërave të zeza.<sup>18</sup>

Përkrah zgjidhjes së problemeve që ndërlidhen me grumbullimin e mbeturinave, është me rëndësi që të krijohen instrumente të qëndrueshme financiare. Krijimi i eko-fondit, që parashihet me Ligjin për mbrojtjen e mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 77), ende as që ka filluar.<sup>19</sup> Për më tepër, nuk ka kushte për zbatimin e instrumenteve financiare tjera përveç buxhetit të Kosovës dhe kontributeve të donatorëve ndërkombëtarë, të cilët kryesisht janë të orientuar nga rehabilitimi dhe mbyllja e deponive. Nga buxheti qendror MMPH-së i ndahen vetëm rreth 2% të mjeteve, ndërsa për mbrojtjen e mjedisit shfrytëzohen drejtpërdrejt vetëm 0.7 të tij. Në buxhetin e vitit 2016, Departamentit për Mbrojtje të Mjedisit brenda MMPH-së i janë ndarë 1.290.154 euro,<sup>20</sup> që përbën rritje të vogël në krahasim me buxhetin e vitit 2015 (1.270.967 euro).<sup>21</sup> Në nivel lokal, ndërmarrjet komunale publike në veri të Kosovës i grumbullojnë taksat për ofrimin e shërbimeve komunale në lartësi prej 3 euro për ekonomi familjare, ndërsa pagesa e të njëjtave është në nivel të kënaqshëm (mesatarisht rreth 70% të ekonomive familjare i paguajnë ato).

Viteve të fundit në Kosovë janë realizuar disa projekte të ofrimit të asistencës teknike për fuqizimin e sektorit të menaxhimit të mbeturinave, të financuar nga donatorët ndërkombëtarë, siç janë BE, Sida, GIZ, ADC dhe të tjerë. Projektet kanë qenë të orientuar drejt fuqizimit institucional dhe ngritjes së kapaciteteve (para së gjithash MMPH), realizimit të projekteve

<sup>17</sup> Intervistë me Drejtorin e NKP Ibar, Zubin Potok, z. Dejan Radojković.

<sup>18</sup> Intervistë me Prof. Dr. Jellena Gjokiq, Këshilltare UNDP për Kryetarin e Komunës së Zveçanit

<sup>19</sup> Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Nr. 03/L-025, i qasshëm në adresën: <http://bit.ly/2jKUvnO>

<sup>20</sup> Ligji për Buxhetin e vitit 2016, Nr. 05/L-071, i qasshëm në adresën: <http://bit.ly/2j9kAMO>

<sup>21</sup> Ligji për Buxhetin e vitit 2015, Nr. 05/L-001, i qasshëm në adresën: <http://bit.ly/2k0bbqO>

specifike në sektorin e mbeturinave dhe projekteve infrastrukturore të cilat mëtonin të problemet e deponive të mbeturinave komunale.

#### **2.4 Problemet në menaxhimin e mbeturinave komunale dhe ndikimi në zhvillim ekonomik**

Edhe pse legjislacioni në fushën e mjedisit në masë të madhe është harmonizuar me direktivat dhe dispozitat e BE-së, problem kryesor përbën implementimi i dobët i dispozitave ligjore, si në nivel qendror ashtu edhe në at lokal. Obligimet dhe përgjegjësitë e MMPH-së, komunave, prodhuesve dhe transportuesve të mbeturinave, janë definuar qartë në Ligjin për mbeturinat, por mungon implementimi i tyre. Si rrjedhojë e këtij problemi, rrezikohen parimet themelore të mbrojtjes së mjedisit, dëmtohet shëndeti i njerëzve dhe negativisht ndikohet në zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik. Në anën tjetër, implementimi i saktë i ligjit do të mund t'i kontribuonte sigurimit të përfitimeve financiare dhe zhvillimit të sektorit privat.

Faktor dominues në kuptim të menaxhimit të mbeturinave përbën vëllimi ekonomik i tyre. Për të qenë fitimprurëse veprimtaria në këtë fushë është e domosdoshme që të grumbullohet një sasi e caktuar e mbeturinave e cila duhet të trajtohet më tej dhe të shitet për qëllime reciklimi. Nga këndvështrimi i veriut të Kosovës, ky problem shfaqet edhe në kuptim të qëndrueshmërisë dhe funksionalitetit të deponisë “Stena e Savës”. Sasitë e mbeturinave të cilat grumbullohen në tri komunat e veriut (Leposaviq, Mitrovicë e Veriut dhe Zveçan) nuk janë të mjaftueshme për t'i siguruar qëndrueshmëri ekonomike kësaj deponie. Për të pasur qëndrueshmëri të tillë, deponia rajonale duhet t'u shërbejë së paku 200.000 banorëve. Megjithatë, numri i banorëve në tri komunat e lartpërmendura nuk e kalon 50.000. Edhe pse komponenti ekologjik dhe social plotësohet përmes projektit të ndërtimit të deponisë rajonale, parashtrohet pyetja se si do të përmbushet komponenti ekonomik pas përfundimit të financimit të Bashkimit Evropian. Përveç kësaj, dokumentacioni projektues nuk është vënë në dispozicion të publikut gjatë kryerjes së këtij hulumtimi, prandaj është e pamundur që të parashikohet se si do të financohet dhe funksionojë deponia më pas. Ekzistojnë vetëm indikacione se përkrahja financiare ka gjasa të sigurohet në formë të subvencioneve nga autoritetet lokale dhe/ose qendrore të Kosovës, që nuk përbën zgjidhje afatgjatë në kuptim të qëndrueshmërisë.

Problem tjetër është funksionimi i ndërmarrjeve komunale publike në veri të Kosovës, e në veçanti statusi i tyre pas ndërtimit të deponisë rajonale. Sistemi i Kosovës nuk i njeh ndërmarrjet komunale publike të regjistruara në sistemin e Republikës së Serbisë, prandaj duhet të vendoset se si do të funksionojnë këto ndërmarrje të cilat aktualisht janë akterët kryesorë të fushës së menaxhimit të mbeturinave në veri të Kosovës. Nga kjo rrjedh pyetja kyçe se si do të harmonizohen këto dy sisteme. Vlen të theksohet se këto ndërmarrje nuk kryejnë vetëm shërbime të grumbullimit të mbeturinave komunale, por edhe shërbime të furnizimit me ujë,<sup>22</sup> pastërtisë publike dhe mirëmbajtjes së gjelbërimit publik.

Megjithatë, roli i tyre në ofrimin e shërbimeve komunale po ndryshon edhe në Serbi. Në fund të vitit 2015 janë miratuar ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Sistemin Buxhetor të

---

<sup>22</sup> Në veri të Kosovës është duke u ndërtuar ujësjellësi rajonal, i cili gjithashtu do të funksionojë sipas sistemit të Kosovës.

Republikës së Serbisë,<sup>23</sup> të cilat kanë hyrë në fuqi më 1 dhjetor 2016. Me këto ndryshime dhe plotësime ndërmarrjet publike, fondet dhe drejtoritë e themeluara nga ana e autoriteteve lokale në Serbi nuk janë më tej shfrytëzues të tërthortë të mjeteve buxhetore, ndërsa financimi i tyre dhe gjetja e zgjidhjeve organizative për to është kompetencë e themeluesve të tyre, do të thotë e komunave. Situata në komuna me shumicë serbe në Kosovë ndërlikohet edhe më tej për shkak të dualizmit në implementim të ligjeve, prandaj nuk është tërësisht e qartë se si do të duken zgjidhjet që do të gjenden për ndërmarrjet komunale publike dhe punonjësit e tyre.<sup>24</sup> Megjithatë, kjo përbën një rast që ky problem të zgjidhet në mënyrë të qëndrueshme në kontekst të formimit të ndërmarrjes rajonale.

Menaxhimi adekuat i mbeturinave gjithsesi mund të përbëjë fillim të mirë në kuptim të përmirësimit të kushteve mjedisore dhe potencialisht nxitës të zhvillimit ekonomik të rajonit. Megjithatë, në veri të Kosovës është i vogël numri i nismave dhe ndërmarrjeve që merren me menaxhimin e mbeturinave, ndërsa edhe nismat e deritashme nuk kanë pasur sukses në afarizmin e tyre.

Pengesa e parë në të cilin hasin ndërmarrësit të cilët do dëshironin të nisnin një biznes në sektorin e mbeturinave është procedura për lëshimin e dokumenteve të domosdoshme. Për të nxitur afarizmin në sektorin e mbeturinave duhet të sigurohet licenca e nxjerrë nga ana e MMPH. Udhëzimi Administrativ i MMPH Nr. 09/2014<sup>25</sup> përcakton se cilat leje dhe vërtetime duhet siguruar për të filluar afarizmin në këtë sektor.<sup>26</sup> Përveç kësaj, për nevoja të eksportit të mbeturinave, subjekti juridik duhet të posedojë leje të veçantë të cilën e lëshon MMPH. Sigurimi i këtyre dokumenteve kërkon më shumë kohë, gjë që shpesh dekurajon ndërmarrësit që do të ishin të gatshëm t'i përvishen kësaj veprimtarie.

Edhe përkundër faktit që nga viti në vit gjenerohen sasi më të mëdha mbeturinash, mungesa e infrastrukturës adekuate rezulton me pamundësi të ndarjes së mbeturinave në deponi apo qendër transportuese. Ekzistimi i një numri të madh të deponive ilegale kufizon fushëveprimin e veprimtarisë së komunitetit privat në këtë sektor. Nëse mbeturinat do të deponoheshin në deponi legale dhe do të vendosej një sistem efikas i grumbullimit dhe ndarjes së mbeturinave, do të ngriteshin edhe gjasat për operim më efikas.

Duke qenë se ndërmarrjet komunale publike janë përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave në këto komuna, përfshirja e sektorit privat në domenin e grumbullimit primar deri sot nuk ka qenë e mundshme. Megjithatë, problemi i grumbullimit të mbeturinave komunale në vise rurale vazhdon të mos ketë zgjidhje nga autoritetet lokale, prandaj ekzistojnë mundësi të përfshirjes së sektorit privat në këtë segment. Sa i përket grumbullimit sekondar dhe ndarjes, në këtë fushë vepron një numër shumë i vogël ndërmarrësish. Me ndërtimin e deponisë në të cilën do të ofrohen këto shërbime, mundësitë e përfshirjes së ndërmarrësve zvogëlohen dukshëm edhe më tej. Në komunën e Zveçanit ka pasur përpjekje të grumbullimit të lëndëve

<sup>23</sup> Gazeta Zyrtare e RS, Nr. 54/2009, 73/2010, 101/2010, 101/2011, 93/2012, 62/2013, 63/2013 - korrigjim, 108/2013, 142/2014, 68/2015 – dhe 103/2015

<sup>24</sup> Në çdo NKP në veri të Kosovës janë të punësuar nga rreth 100 punonjës.

<sup>25</sup> Udhëzimi Administrativ i MMPH Nr. 09/2014 për Licenca për Menaxhim të Mbeturinave, i qasshëm në adresën: <http://bit.ly/2iJ6d0C>

<sup>26</sup> Lejen komunale mjedisore për menaxhim të mbeturinave, certifikatën e regjistrimit të veprimtarisë afariste, vërtetimin për tatimin e paguar, planin e menaxhimit të mbeturinave, certifikatën e numrit fiskal, etj.

të para sekondare, por e përballur me shumë pengesa, kryesisht ligjore, ndërmarrja “Regjioni i gjelbër” ndërpreu veprimtarinë e vet. Vendosja e taksave doganore për eksport të plastikës dhe letres së presuar për nevoja përpunimi nga fabrikat e Serbisë në vitin 2012 ishte një nga arsyet kryesore për ndërprerje të veprimtarisë. Për transportim të mbeturinave në Republikën e Serbisë është kërkuar edhe leja e importit. Përveç kësaj, sasi të e grumbulluara të mbeturinave kanë qenë të pamjaftueshme për furnizim të rregullt, prandaj mesatarisht në drejtim të Serbisë është eksportuar vetëm nga një kamion me plastikë dhe letër. Shpenzimet e larta të transportit, fuqia punëtore e dobët, përkrahja e pamjaftueshme nga organet kompetente dhe qytetarët, i kanë kontribuar mospësuksit të kësaj ndërmarrjeje. Përkrahja me kompani tjera në vise tjera të Kosovës nuk është realizuar, marrë parasysh faktin se riciklimi vazhdon të mbetet në fazë fillestare të zhvillimit.

Gjithashtu, investimi i qëndrueshëm në infrastrukturë përbën një nga problemet më të rëndësishme në sektorin e mbeturinave komunale. Themelimi i eko-fondit do të kishte ndikim pozitiv në zgjidhjen e këtij problemi. Edhe pse versioni i punës i ligjit që trajton themelimin e fondit është hartuar para disa vitesh, ende nuk ka ndonjë përparim të dukshëm. Arsyeja qëndron në faktin që Ministria e Financave ka pengesa ligjore kur është në pyetje financimi i një organi të ri për mbrojtjen e mjedisit nga buxheti qendror, prandaj ende po negociohet me MMPH se si të zgjidhet ky problem. Zgjidhja e qëndrueshme për financim të projekteve dhe programeve të gjelbra ende nuk ekziston. Ekzistojnë vetëm mjetet në buxhetin qendror që janë të parapara për avancimin e mjedisit. Për shembull, në këtë buxhet orientohen taksat ekologjike të grumbulluara<sup>27</sup> për regjistrim dhe sigurim të veturave me tabela të huaja<sup>28</sup> por problemi qëndron në faktin se këto mjete tejet rrallë përdoren për projekte dhe programe ekologjike.

## **2.5 Përfundimi dhe rekomandimet**

Ndotja e mjedisit si rrjedhojë e menaxhimit joadekuat të mbeturinave komunale përbën një nga problemet kyçe në fushën e mbrojtjes së mjedisit në Kosovë. Edhe pse është nxjerrë një mori ligjesh dhe aktesh nënligjore për të trajtuar fushën e mbeturinave, si dhe strategjitë e planit përkatëse në nivel qendror, ende ekzistojnë sfida të theksuara me të cilat duhet të përballen organet kompetente.

Mosekzistimi i një sistemi efikas për menaxhim të mbeturinave ndikon në degradimin çdo herë e më të madh të mjedisit jetësor, si dhe në cilësinë e jetës së qytetarëve. Situata aktuale në masë të madhe ndikon në zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Para së gjithash, me zbatim të dobët të ligjeve, mungesë infrastrukture për deponim dhe trajtim të mbeturinave, mangësi kapacitetesh të autoriteteve kompetente për të zgjidhur çështjet që ndërlidhen me sektorin e mbeturinave, si dhe me përkrahje financiare të ulët i është kontribuar përkeqësimit të situatës edhe ashtu të keqe në këtë sektor. Mundësitë e kësaj së sektorit privat për momentin janë të kufizuara për shkak se ende nuk janë krijuar kushtet dhe klima pozitive për afarizëm privat në

<sup>27</sup> Për vetura nën 3.5t taksa ekologjike është 10€, ndërsa për vetura mbi 3.5t është 30€ - Shtojca C e Ligjit për Taksat Rrugore dhe Ekologjike të Automjeteve, Nr. 04/L-117, i qasshëm në adresën: <http://bit.ly/2iBHf8m>, f. 5

<sup>28</sup> Neni 1 i Ligjit për Taksat Rrugore dhe Ekologjike të Automjeteve, Nr. 04/L-117.

sektorin e mbeturinave. Për të joshur ndërmarrësit në këtë sferë në të ardhmen duhet të bëhen përpjekje shtesë, si nga ana e autoriteteve qendrore ashtu edhe nga ato lokale.

Avancimi i mjedisit me zhvillimin e sektorit privat në fushën e trajtimit të mbeturinave komunale gjithsesi mund t'i kontribuojë kushteve më të mira të jetesës në komunitetin lokal dhe zbutjes së varfërisë. Vetëm zhvillimi i infrastrukturës do të mund të përbënte burim të të hyrave dhe do të mund të siguronte krijim të vendeve të reja të punës. Prandaj, investimi në projekte dhe programe 'të gjelbra' është i domosdoshëm për t'i kontribuar zhvillimit të qëndrueshëm në veri të Kosovës.

Në bazë të asaj që u tha më lartë, janë nxjerrë rekomandimet në vijim në të cilat duhet të punohet në të ardhmen:

- Ofrimi i përkrahjes për autoritetet e vetëqeverisjes lokale në veri të Kosovës në kuptim të ngritjes së kapaciteteve për menaxhim të mbeturinave komunale;
- Nisja e procesit të ristrukturimit të ndërmarrjeve komunale publike që merren me grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave komunale dhe procesit të formimit të ndërmarrjes rajonale e cila do të menaxhojë me deponinë. Këto dy detyra duhet të realizohen bashkërisht e kurrësi ndaras;
- Ngritja e nivelit të investimeve nga autoritetet lokale, qendrore dhe donatorët në projekte të fushës së zgjidhjes së problemeve të mbeturinave komunale dhe deponive ilegale, posaçërisht në vise rurale;
- Komunave në veri të Kosovës t'u paraqiten shembuj të praktikave të mira të partneritetit publiko-privat në fushën e menaxhimit të mbeturinave komunale, si shembuj të ndërmarrjeve të suksesshme që operojnë në fushën e mbeturinave.

# Menaxhimi me mbeturinat komunale në Kosovë

Të shfrytëzojmë fuqinë e mbeturinave

## Institucionet joefikase



Nuk implementohet korniza ekzistuese legislative

Kapacitete të dobëta institucionale për menaxhim të mbeturinave komunale

Ndarje të pamjaftueshme buxhetore për zgjidhje të çështjeve që ndërlidhen me mbeturinat komunale

## Problemet infrastrukturore në grumbullimin, depozitimin dhe trajtimin e mbeturinave komunale

Numri i pamjaftueshëm i deponive funksionale

Mospajtueshmëria me standardet e BE-së

Përqindja e vogël e mbeturinave të ricikluara

Probleme me grumbullimin e mbeturinave në vise rurale



## Rritja e sasisë së mbeturinave komunale (Mesatarisht / ditë / për kokë banori)

2007  
0.5 kg

2013  
0.9 kg



## Mbeturinat komunale – vetëm shpenzim, e jo resurs i vlefshëm

Vetëdija e ulët lidhur me potencialet e mbeturinave

Kapacitetet e pashfrytëzuara të mbeturinave për zhvillim të sektorit





### 3 PYJET NË KOSOVË – NJË PASURI QË PO ZHDUKET

#### 3.1 Hyrje

Duke qenë se pyjet e mbulojnë pothuajse gjysmën e territorit të Kosovës (47% të territorit të gjithmbarshëm<sup>29</sup>) ato përbëjnë potencial të jashtëzakonshëm për zhvillim ekonomik, në veçanti në vise rurale. Megjithatë, në zhvillimin e mëtejshëm në masë të madhe ndikon prerja e jashtëligjshme e pyjeve e cila viteve të fundit ka marrë hov. Pasojat e prerjes janë të dukshme edhe në rrafshin e mbrojtjes së mjedisit, i cili zakonisht gjendet në fund të listës së prioriteteve por të cilit tash po i kanoset çdo herë e më shumë degradimi.

Politikat në fushën e pylltarisë janë të lidhura ngushtë me sektorë tjerë, siç janë mjedisi, bujqësia, zhvillimi rural, industria, turizmi dhe punësimi. Kur është në pyetje mjedisi jetësor, menaxhimi i pyjeve kërkon qasje që bazohet në respektim të parimeve ekologjike, gjë që në praktikë nuk ndodhë në Kosovë.

Kjo analizë e shkurtër përbën një pasqyrë të gjendjes aktuale të pylltarisë në Kosovë, si dhe ndikimin e aktiviteteve të ndërlidhura me pyjet në mjedisin jetësor. Ajo gjithashtu analizon legjislacionin nga fusha e pylltarisë si dhe ndërlidhshmërinë e kësaj fushe me zhvillimin ekonomik.

#### 3.2 Legjislacioni dhe institucionet

Ligji i parë për pyjet në Kosovë (2003/3), është përgatitur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) për të rregulluar menaxhimin e pyjeve dhe tokave pyjore në posedim publik dhe privat, si dhe menaxhimin e pyjeve në parqe nacionale. Ky ligj është ndryshuar dhe plotësuar dy herë deri tani. Në pajtim me rregullativën e BE-së, në vitin 2015 është përgatitur projektligji i ri për pyjet por ai ende nuk është miratuar nga na e Kuvendit. Përveç Ligjit për Pyjet, në fuqi janë edhe disa ligje tjera të cilat prekin fushën e pylltarisë.<sup>30</sup>

Legjislacioni në fushën e pylltarisë është ngushtë i lidhur edhe me legjislacionin nga fusha e mjedisit. Kësisoj, për shembull, Ligji për Pyjet qartëson se me pyjet në Kosovë do të menaxhohet në pajtim me parimet ekologjike të ruajtjes së biodiversitetit, të ndërmarrjes së masave preventive dhe sigurimit të zhvillimit të qëndrueshëm nga këndvështrimi ekologjik.

Përkrah legjislacionit primar, edhe legjislacionit sekondar i është kushtuar kujdes i duhur, andaj janë hartuar edhe dokumentet strategjike si Politika dhe strategjia e zhvillimit të sektorit të pylltarisë 2010-2020 dhe Plani i veprimit për implementimin e politikës dhe strategjisë 2010-2020, Strategjia dhe plani i veprimit për biodiversitet 2011-2020. Përveç strategjive,

<sup>29</sup> Gjendja e mjedisit në Kosovë 2015, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, gjendet në [http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Serbisht\\_final.pdf](http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Serbisht_final.pdf), çasja e fundit 29 nëntor 2016.

<sup>30</sup> Ligji për mbrojtjen nga katastrofat natyrore dhe të tjera Nr. 04/L-027; Ligji për Gjyëtinë Nr. 02/L-052; Ligji për Rregullimin e Tokave Nr. 04/L-040; Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025; Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-033; Ligji për Mbrojtjen nga Zjarri Nr. 02/L-51; Ligji për Materialet Fidanore Nr. 2004/13; Ligji për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor Nr. 03/L-024; Ligji për Zonat e Posaçme të Mbrojtura Nr. 03/L-039.

MBPZHR së paku çdo dhjetë vite miraton plane afatgjata për menaxhimin e pyjeve publike. Sipas Ligjit për pyjet, në rast të shpalljes së një plani afatgjatë të pavlefshëm për shkak të ndryshimeve të shkaktuara nga zjarri, sëmundjet, stuhitë apo prerja e paligjshme, në funksion hyjnë planet vjetore. Planet vjetore (ekonomike-të pylltarisë) të menaxhimit të pyjeve shfrytëzohen për çdo njësi ekonomike dhe për fusha të tëra pyjore. Kosova ka 84 njësi ekonomike, ndërsa 13 prej tyre i përkasin veriut të Kosovës.

Falë ndihmës të cilën e ka ofruar FAO<sup>31</sup> dhe qeveritë e disa shteteve, në Kosovë është ndërtuar struktura institucionale për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e pyjeve. MBPZHR është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave mbi pyjet e Kosovës. Pjesë integrale e MBPZHR është Departamenti për Pyjet, i cili është përgjegjës për hartimin e politikave, infrastrukturën ligjore dhe inspektionin. Agjencia e Pyjeve të Kosovës është organ i themeluar në vitin 2003 nën ombrellën e MBPZHR i cili menaxhon me tokat pyjore publike dhe private dhe me pyjet në parqe nacionale,<sup>32</sup> ndërsa është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve nga fusha e pylltarisë, lëshimin e lejeve për grumbullim të prodhimeve pyjore jodrusore, monitorimin e prerjes së pyjeve dhe zhvillimin e resurseve pyjore. Agjencia e Pyjeve ka gjashtë drejtori në 6 qytete të Kosovës (Prishtinë, Pejë, Mitrovicë, Prizren, Gjilan dhe Ferizaj). Në Pejë është themeluar edhe Instituti për Pylltari i cili kryen hulumtime nga kjo fushë. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) gjithashtu luan rol të rëndësishëm në kuptim të menaxhimit të pyjeve. Në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë, e cila funksionon si pjesë e MMPH-së, ekziston departamenti për menaxhimin e parqeve nacionale<sup>33</sup> në territorin e Kosovës, në pajtim me ligjet nga fusha e mjedisit.<sup>34</sup>

Nga viti 2010, sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040), komunat kanë edhe kompetenca të deleguara nga ana e Agjencisë e të cilat ndërlidhen me mbrojtjen e pyjeve dhe lëshimin e lejeve për prerjen e pyjeve publike dhe private.

Sistemi ligjor dhe institucional i Kosovës ende nuk zbatohet në komunat e veriut të Kosovës. Në komunat veriore punët në fushën e mbrojtjes dhe menaxhimit të pyjeve kryhen nga Ndërmarrja Pyjore “Ibar” në Leposaviq, e cila funksionon nën ombrellën e NP “Srbijashume” me qendër në Beograd. Në këtë ndërmarrje funksionon edhe drejtoria për pyje në Zubin Potok. Megjithatë, pas nënshkrimit të marrëveshjes së Brukselit është në rënie përkrahja nga baza në Beograd, duke qenë se kjo marrëveshje parashih edhe integrimin e “Srbijashume” në sistemin e Kosovës.<sup>35</sup> Agjencia e Pyjeve e Kosovës aktualisht punëson disa punëtorë në këto dy komuna të cilat punojnë në sistemin e Kosovës dhe kanë kompetenca për lëshimin e lejeve vetëm për prerjen e pyjeve private në këtë rajon.

<sup>31</sup> Organizata për Ushqim dhe Bujqësi e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

<sup>32</sup> Menaxhimi i pyjeve në Parqe Nacionale është kompetencë e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa sipas Ligjit për Pyjet, ajo është kompetencë e Agjencisë së Pyjeve të Kosovës, andaj paraqitet problem lidhur me konfliktin e kompetencave.

<sup>33</sup> Nga tërë territori i mbuluar me pyje në Kosovë, parqet nacionale mbulojnë 25%.

<sup>34</sup> Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233, Ligji për Parkun nacional Mali i Sharrit Nr. 04/L-087, etj.

<sup>35</sup> FAO në bashkëpunim me UNDP (Programi për Zhvillim i Organizatës së Kombeve të Bashkuara) është duke implementuar një projekt që përbën pjesë të itnegrimit të NP Srbijashume në sistemin e Kosovës, në pajtim me marrëveshjen e Brukselit.

### 3.3 Gjendja aktuale në pylltari dhe ndikimi në mjedis

Në periudhën nga viti 2012 deri në vitin 2013, në Kosovë është kryer regjistrimi i pyjeve<sup>36</sup> me qëllim të grumbullimit të të dhënave relevante të domosdoshme për zhvillim të sektorit të pylltarisë dhe vlerësimit të qëndrueshmërisë së menaxhimit të pyjeve. 47% të tërë territorit të Kosovës është i mbuluar me pyje, nga të cilat 62% janë në pronësi publike e 38% në atë private.<sup>37</sup> Regjistrimi ka dëshmuar se pyjet në Kosovë paraqesin burimin kryesor të energjisë për ngrohje, si në vise rurale ashtu edhe në ato urbane (rreth 90% të popullatës i shfrytëzon drutë për ngrohje). Në anën tjetër, sipas studimit të kryer nga Qendra e RIT për energji dhe burime natyrore, në Kosovë çdo vit shpenzohen mes 2.4 dhe 2.9 milionë metra kub për ngrohje.<sup>38</sup> Sipas vlerësimeve të MBPZHR dhe Grupit Norvegjes për Pylltari, kjo përbën rreth 1.2 milionë metra kub më shumë se sa sasia që me ligj lejohet të prehet brenda një viti.<sup>39</sup> Për ta zvogëluar degradimin e pyjeve dhe ndikimin negativ të prerjes së pyjeve në mjedis, Qeveria e Kosovës stimulon importimin e masës drusore për ngrohje.

Është fakt se pyjet përbëjnë pasuri të madhe dhe lehtë të qasshme dhe që kërkesa për to është shumë më e lartë se sa oferta, gjë që ka ndikuar që pyjet të shndërrohen në shënjestër të veprimtarisë joligjore të popullatës lokale. Siç është theksuar edhe më sipër, menaxhimi me pyjet private dhe publike është rregulluar me Ligjin për Pyjet, i cili parasheh lëshimin e detyrueshëm të lejeve për prerjen e drujve nga ana e organit kompetent. Lëshimi i lejeve për prerje bëhet nga komunat, ndërsa e ashtuquajtura damkosje, respektivisht vulosje që identifikon prerjen e ligjshme është e domosdoshme për të kryer transportimin e druve. Sipas të dhënave të nxjerra nga regjistrimi i pyjeve, 93% të prerjes së pyjeve nuk bëhet në pajtim me dispozitat ligjore, nga të cilat 59% në pyjet shtetërore e 34% në ato private. Me fjalë tjera, vetëm 7% e prerjes së druve bëhet në pajtim me ligjin. Dëmet që i shkaktohen pyjeve dhe ekosistemit pyjor nga kjo janë të jashtëzakonshme. Degradimi i tokës pyjore, erozioni, zvogëlimi i emetimit të oksigjenit, shkatërrimi i biodiversitetit, rritja e rrezikut nga përmbytjet dhe zjarret pyjore janë vetëm disa nga pasojat kryesore të drejtpërdrejta të veprimtarisë njerëzore. Përveç faktorit njeri ekzistojnë edhe një sërë faktorësh tjerë që paraqesin shkaktarë të rrezikimit të pyjeve dhe tokës pyjore, posaçërisht sëmundjet, insektet dhe fatkeqësitë natyrore. Nga 481.000ha të mbuluara me pyje në Kosovë, vlerësohet se të degraduara janë 165.469 ha, ndërsa humbjet e gjithmbarshme si pasojë e degradimit të tokës arrijnë 16.7 – 19.5 milionë euro.<sup>40</sup>

Edhe pse me qëllim të harmonizimit me *Acquis Communautaire* të BE-së gjatë viteve të fundit janë nxjerrë një sërë ligjesh nga fusha e pylltarisë, mungojnë mekanizmat adekuatë për implementimin e tyre. Kapacitetet për zbatim të ligjeve janë limituar për shkak se mbrojtja

<sup>36</sup> Regjistrimi i pyjeve ofron informata të besueshme mbi gjendjen, nivelin dhe zhvillimin e pyjeve, në bazë të vlerësimeve nga terreni.

<sup>37</sup> Studimi “Regjistrimi Kombëtar i Pyjeve të Kosovës 2012”, Prishtinë, 2013., mund të gjendet në faqen: <http://bit.ly/2rUKfAp>, f. 8.

<sup>38</sup> Studimi “Shfrytëzimi i energjisë në amvisëritë e Kosovës” është kryer edhe në komunat e veriut të Kosovës. Ai mund të gjendet në faqen: <http://bit.ly/1M4tPb0>, f. 2.

<sup>39</sup> Bisedimet e BE: EUICC Diskuton mbi Rëndësinë e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës, mund të gjendet në faqen: <http://bit.ly/2fwHVC3>

<sup>40</sup> Analiza Mjedisore e Vendit, Banka Botërore, janar 2013., mund të gjendet në faqen: <http://bit.ly/2qB4Fid>, f. 48.

nga eksploatimi i pyjeve varet nga shumë faktorë. Një nga faktorët kyçë konsiderohet fakti që nuk ekziston një bashkëpunim efikas mes institucioneve që merren me mbrojtjen e pyjeve dhe institucioneve tjera, posaçërisht me policinë dhe gjyqësorin. Kjo përbën problem të posaçëm në veriun e Kosovës ku prerja e tepruar e pyjeve nuk ndëshkohet në bazë të ligjit. Situata ndërlikohet edhe më tej kur kemi paraysh dualitetin e sistemit dhe ekzistimin e strukturave institucionale paralele të cilat nuk janë funksionale. Nëse prerja joligjore e druve në komunitat në veri të Kosovës vërtetohet nga inspektorët e NP “Srbijashume”, policia nuk del në terren dhe nuk shqipton kundërvajtje sepse nuk e njeh autoritetin e këtij institucioni brenda kuadrit të sistemit kosovar. Sa u përket inspektorëve të pyjeve të cilët funksionojnë nën sistemin kosovar, në pjesën jugore të Mitrovicës ekziston një njësi për inspektim e cila ka të drejtën formale ligjore për të ushtruar kompetencat edhe në veri, por ata shumë rrallë dalin në terren në komunitat e veriut. Në bazë të Ligjit për Pyjet, për prerjen joligjore të pyjeve mund të shqiptohen gjoba deri në 25.000 euro, por janë të rralla rastet kur një politikë e tillë ndëshkimore është zbatuar jo vetëm në veri por edhe në pjesët tjera të Kosovës.

Kur është në pyetje përkrahja financiare, nga viti 2000 në zhvillimin e sektorit të pylltarisë janë investuar mjete të konsiderueshme që kanë përfshirë investime materiale, krijim të strukturës menaxhuese dhe organizative, formësimin e kornizës ligjore, përkrahjen në planifikim, ngritjen e kapaciteteve për implementim të ligjeve, krijimin e sistemit informativ, etj. Përveç FAOs, që ka ofruar përkrahjen më të madhe në hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në pajtim me Acquis Communautaire të BE-së, ky sektor ka gëzuar edhe përkrahjen e donatorëve tjerë, siç janë SIDA, BE, GIZ, UNDP, USAID, Qeveritë e Holandës dhe Finlandës dhe Grupit Norvegjez për Pylltari, si dhe shumë të tjerëve. Vlerësohet se deri tani në këtë sektor janë investuar rreth 13.7 milionë euro.<sup>41</sup> Por, donatorët nuk kanë vepruar në ndonjë nivel të theksuar në veri të Kosovës, para së gjithash për shkak të dualitetit të sistemit. Investimet kanë qenë të mundshme vetëm përmes komunave, asociacioneve apo shoqatave, por përveç realizimit të disa projekteve të pyllëzimit, nuk janë implementuar projekte më të mëdha të cilat do të kontribuonin në nivel më të theksuar në përmirësimin e gjendjes së pyjeve.

Ligji për Pyjet i vitit 2003 parashihte krijimin e Fondit për ripërtirjen e pyjeve nën ombrellën e MBPZHR, e me qëllim të mundësimin të investimeve dhe inkurajimit të investitorëve për investime në sektorin e pylltarisë. Megjithatë, Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë Nr. 03/L-048 parasheh kushte të veçanta kur bëhet fjalë për krijimin e një fondi të veçantë brenda MBPZHR, si organ i pavarur. Mjetet nga buxheti qendror që ndahen për departamentin e pylltarisë janë relativisht modeste (10% të buxhetit të gjithmbarshëm të MBPZHR<sup>42</sup>), prandaj për të përkrahur sektorin e pylltarisë, Qeveria e Kosovës ndanë edhe një pjesë të mjeteve të grumbulluara nga shitja e pyjeve publike dhe taksat. Megjithatë, nuk ka dyshim se janë të nevojshme investime më të theksuara për të përmirësuar nivelin e mbrojtjes së pyjeve dhe mjedisit jetësor në pyje, me çka do t'i kontribuohet edhe zhvillimit socioekonomik të Kosovës.

<sup>41</sup> Programi kombëtar për implementimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, mars 2016, mund të gjendet në faqen: <http://bit.ly/2rUMofF>, str. 336.

<sup>42</sup> Buxheti i MBPZHR në vitin 2016 arrin rreth 57 milionë euro.

### 3.4 Pylltaria në Kosovë – potenciali për zhvillim ekonomik?

Pylltaria dhe industria e drurit përbëjnë element të rëndësishëm të ekonomisë në Kosovë dhe me menaxhim adekuat do të përbëjnë potencial të jashtëzakonshëm për zhvillim. Vlera e gjithmbarshme e pasurisë pyjore vlerësohet në 50-75 milionë euro dhe kontribuon në BPV-në e vendit me 1.8-2.6%.<sup>43</sup> Është fakt se përfitimet ekonomike të cilat sigurohen me shitjen e masave drusore kanë si rrjedhojë rritjen e shfrytëzimit të pyjeve dhe tokës pyjore. Sipas të dhënave nga regjistrimi, vlerësohet se çdo vit prehen rreth 1,6 miliona m<sup>3</sup> dru, nga të cilat pjesa më e madhe prehen në mënyrë jologjore. Gjithashtu, vlerësohet se të ardhurat nga shitja e pyjeve ligjërish të prera do të mund të rriteshin nga 1.5 milionë euro në 8 milionë euro, nëse të gjitha pyjet do të menaxhoheshin në mënyrë adekuate.<sup>44</sup> Megjithatë, një nga shtytësit kryesorë të prerjes jologjore të pyjeve është statusi i keq ekonomik i popullatës, në veçanti në viset rurale. Norma e papunësisë në Kosovë është mes më të lartave në Evropë dhe shënon 32,9%.<sup>45</sup> Mbulueshmëria e mirë me pyje, qasja e lehtë, kontrollet e dobëta inspektuese, mungesa e burimeve njerëzore dhe ekspertizës, si dhe mosfunksionimi i sistemit të drejtësisë e bëjnë pylltarinë më joshëse për veprimtari jologjore. Kjo është në veçanti karakteristikë e viseve rurale, ku popullata tradicionalisht siguron të hyra duke u marrë me bujqësi dhe veprimtari të ndërlidhur me prerjen e pyjeve.

Nëse e analizojmë veriuin e Kosovës, komunat Zubin Potok dhe Leposaviq janë jashtëzakonisht të pasura me pyje (mbulueshmëria 67%, respektivisht 40%), prandaj edhe ekziston potencial i madh për eksploatim ekonomik të këtij resursi. Megjithatë, duke qenë se sistemi i menaxhimit të pyjeve pothuajse nuk ekziston fare, edhe në sistemin e Kosovës edhe në atë të Serbisë pyjet prehen dhe shkatërrohen në mënyrë të pakontrolluar.<sup>46</sup>

Për shkak të shpenzimeve të larta doganore, masa drusore nga veriu i Kosovës kryesisht transportohet me kanale ilegale deri tek tregjet në Serbi, ndërsa transporti në vise tjera të Kosovës kryhet vetëm në rastet kur për prerjen dhe transportin e druve janë dhënë lejet përkatëse nga punëtorët komunalë që punojnë nën Agjencinë e Pyjeve. Procedurat administrative doganore dhe të tjera, mes tjerash, kanë ndikuar në ndërprerjen e punës së fabrikës së mobilieve “Simpò” në Zubin Potok, si rrjedhojë e së cilës mbi 120 punëtorë kanë mbetur pa punë. Duhet të theksohet se kjo fabrikë ka eksportuar 70% të prodhimit të vet, kryesisht në shtete të Skandinavisë, ndërsa prodhimtaria është varur nga importi i lëndës së parë.<sup>47</sup> Me vendosjen e detyrimeve doganore, shpenzimet e prodhimit të mobilieve janë ngritur dukshëm, gjë që ka ndikuar në konkurrueshmërinë e produkteve.

Pyjet gjithashtu përbëjnë potencial për zhvillim rural dhe zhvillim të turizmit. Përkrah masës drusore në pyje, ekziston edhe një potencial i jashtëzakonshëm ekonomik për grumbullim të bimëve mjekësore dhe produkteve ushqimore në pyje. Përveç kësaj, pyjet paraqesin një resurs

<sup>43</sup> Strategjia për mbrojtjen e mjedisit 2011-2020, MMPH, mund të gjendet në faqen: <http://bit.ly/2rFll82>, f. 33.

<sup>44</sup> Prerja ilegale e druve në Kosovë (nën Rezolutën 1244/1999), STUDIMI FAKT MBLLEDHËS, dhjetor 2009, mund të gjendet në faqen: <http://bit.ly/2rUQTa3>, f. 13.

<sup>45</sup> Agjencia për Statistika e Kosovës

<sup>46</sup> Vlerësohet se në këtë pjesë 75% e prerjes së pyjeve nuk bëhet në pajtim me ligjin. Burimi: Intervista me Zëvendësdirjtorin Teknik të Ekonomisë Pyjore Ibar nga Leposaviqi.

<sup>47</sup> Resurset lokale drusore nuk kanë arritur të plotësojnë më shumë se 30% të kërkesës së fabrikës së mobilieve “Simpò”.

ekologjik të rëndësishëm sepse mbrojnë burimet e ujit të pijes, mbrojnë nga baticat dhe rrëshqitja e dheut, mbrojnë pasurinë e florës dhe faunës dhe prodhojnë ajër të pastër. Për këto arsye, eksploatimi efikas i pyjeve përbën një nga prioritetet kryesore të fuqizimit ekonomik të Kosovës.

### 3.5 Përfundimi dhe rekomandimet

Prerja ilegale e pyjeve në Kosovë është duke u zhvilluar çdo herë e më shumë dhe aktualisht paraqet sfidën më të madhe në fushën e pylltarisë, me të cilën përballen autoritetet lokale dhe qendrore. Të gjitha përpjekjet e deritanishme për të vendosur baraspeshë mes realizimit të përfitimeve ekonomike dhe nevojës për ruajtje të resurseve natyrore të pyjeve kanë dështuar. Situata në terren qartë dëshmon se është e domosdoshme që të kontrollohet prerja e pyjeve, në mënyrë që ato të mund të eksploatohen në pajtim me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Si rrjedhojë, është e domosdoshme që të ndërmerren hapa shtesë për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe dokumenteve strategjike.

Edhe pse për zhvillimin e sektorit të pylltarisë viteve të fundit komuniteti ndërkombëtar ka investuar mjete të konsiderueshme, në veçanti në domenin e krijimit të kornizës institucionale dhe legislative në pajtim me rrjedhat ligjore të Bashkimit Evropian, janë të domosdoshme investime të mëtejme nëse mëtohet përmirësimi i gjendjes aktuale. Përveç përkrahjes financiare, e rëndësisë kyçe është krijimi dhe forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit mes institucioneve relevante i cili aktualisht është në nivel mjaft të ulët, në veçanti në veri të Kosovës.

Zgjidhja e problemeve në fushën e pylltarisë dhe mjedisit jetësor gjithsesi kërkon funksionim më efikas të tërë sistemit. Parashtrohet pyetja se edhe sa gjatë do të vuajë mjedisi si pasojë e moskoordinimit të personave përgjegjës për mbrojtjen e tij? Është evidente që tejkalimi i problemeve të cekura në këtë dokument mund të bëhet duke investuar më shumë kohë dhe mund nga personat përgjegjës, por nga ta kërkohet të veprohet urgjentisht nëse duam të parandalojmë shkatërrimin e mëtejshëm të mjedisit tonë.

Në bazë të asaj që u tha më lartë, janë nxjerrë rekomandimet në vijim në të cilat duhet të punohet në të ardhmen:

- Të forcohen mekanizmat për zbatim më efikas të politikave në fushën e pylltarisë në nivel qendror dhe lokal në Kosovë;
- Të reformohet NP “Srbijashume” dhe të formohen shërbime efikase të inspekcionit për mbrojtjen dhe menaxhimin e pyjeve në veri të Kosovës;
- Të shtohen investimet në sektorin e pylltarisë në veri të Kosovës;
- Të punohet në forcimin ekonomik të popullatës në vise rurale për të ulur nivelin e eksploatimit të pyjeve nga ta;
- Të ngritet vetëdija lidhur me domosdoshmërinë e mbrojtjes së pyjeve dhe rëndësinë e tyre për zhvillim të qëndrueshëm dhe mbrojtje të mjedisit.

# T'i mbrojmë pyjet në Kosovë

pasuri që po zhduket

## Korniza joadekuarte ligjore

Probleme sistematike në zbatimin e ligjit mbi pyjet



1,600,000 m<sup>3</sup>



## Prerja e pyjeve

Në vit prehen 1,600,000 m<sup>3</sup> dru, prej të cilave vetëm 7 për qind sipas ligjit



165,469 ha



Nga 481,000 ha me pyje 165,469 ha janë të degraduara

## Degradimi i mjedisit jetësor

Humbja vjetore përmes degradimit vlerësohet të jetë 16,7 deri 19,5 milionë Euro.



## 4 ZHVILLIMI I BUJQËSISË NË KOSOVË DHE NDIKIMI I SAJ NË MJEDIS

### 4.1 Hyrje

Më shumë se gjysma e territorit të Kosovës është e mbuluar me tokë bujqësore, ndërsa përqindja e popullatës që jeton në viset rurale arrin në mbi 60%. Bujqësia gjithashtu konsiderohet si një nga sektorët më kyç për zhvillim, si nga ana e autoriteteve lokale e qendrore ashtu edhe nga ana e donatorëve ndërkombëtarë. Mjetet që investohen në zhvillim të bujqësisë rriten nga viti në vit. Në krahasim me vitin 2007, kur nga buxheti i Qeverisë së Kosovës janë ndarë rreth 6 milionë euro, i njëjti në vitin 2013 ka arritur 31 milionë euro. Trend pozitiv ekziston edhe kur flitet për mjetet e donatorëve ndërkombëtarë, duke qenë se në vitin 2007 janë investuar 300,000 euro, në vitin 2013 janë investuar 3 milionë, ndërsa në vitin 2015 janë ndarë 11 milionë euro.<sup>48</sup>

Mbrojtja e mjedisit, bujqësia dhe zhvillimi rural janë sektorë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, prandaj kurrësi nuk guxon të neglizhohet ndikimi i bujqësisë në mjedisin jetësor që na rrethon. Masat të cilat njeriu i realizon me qëllim të intensifikimit të prodhimit bujqësor kanë ndikime edhe pozitive edhe negative në agrosistem. Prandaj, qëllimi është të prodhohet ushqim cilësor, por edhe të kursehen resurset dhe energjia, të mbrohet mjedisi, të sigurohet efikasitet ekonomik dhe avancohet jetesa e bujqve dhe komunitetit në përgjithësi.

Kjo analizë e shkurtër paraqet legjislacionin aktual dhe gjendjen momentale në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Kosovë, ndikimin e tyre në mjedis dhe ndërlidhshmërinë e tyre me zhvillim ekonomik.

### 4.2 Korniza ligjore dhe institucionale

Në proces të krijimit të kornizës ligjore në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, në pajtim me Acquis Communautaire të BE-së, në Kosovë janë miratuar shumë ligje, akte nënligjore dhe dokumente strategjike. Akti më i rëndësishëm ligjor nga kjo fushë është Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural Nr. 03/L-098, i miratuar në vitin 2009. Disa vite më pas (në vitin 2012), është miratuar Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural<sup>49</sup>, i cili pjesërisht është harmonizuar me Rregulloren Nr. 73/2009 të BE-së.<sup>50</sup> Në anën tjetër, harmonizimi me Rregulloren e BE-së ende nuk është arritur nga ligjet në vijim: Ligji për rregullimin e tokës (Nr. 04/L-040), Ligji për tokën bujqësore (Nr. 02/L-26), Ligji për ujitjen e tokës bujqësore (nr. 02/L-09), Ligji për inspektoratin bujqësor (Nr. 03/L-029), Ligji për kooperativat bujqësore (Nr. 2003/9). Përveç ligjeve të përmendura, viteve të

<sup>48</sup> IPA 2014-2020, Përkrahje e mëtejme e zhvillimit të sektorit agro-rural dhe sigurisë së ushqimit në Kosovë, 2015, në faqen: <http://bit.ly/2smnXnA>, f. 7.

<sup>49</sup> Ligji Nr. 04/L-090, në faqen: <http://bit.ly/2qGHuhl>

<sup>50</sup> Programi kombëtar për implementimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, mars 2016, në faqen: <http://bit.ly/2rUMofF>, f. 176.




fundit janë miratuar edhe disa ligje që janë drejtpërdrejt apo tërthorazi të ndërlidhur me sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Kosovë.<sup>51</sup>

Legjislacioni në fushën e mbrojtjes së mjedisit është po ashtu tejet i rëndësishëm për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Ligje kyçe nga kjo fushë e që prekin bujqësinë janë: Ligji për mbrojtjen e mjedisit Nr. 03/L-025, Ligji për vlerësimin e ndikimit mjedisor Nr. 03/L-024, Ligji për mbrojtjen e integruar dhe kontrollin e ndotjes Nr. 03/L-043, etj.<sup>52</sup> Sipas disa vlerësimeve, rreth 60% e *Acquis Communautaire* të BE-së nga fusha e mbrojtjes së mjedisit tani është transpozuar në legjislacionin vendor.<sup>53</sup>

Viteve të kaluara në Kosovë janë hartuar disa dokumente strategjike nga fusha e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Gjithashtu, janë hartuar strategji dhe plane veprimi nga fusha e mjedisit, të cilat janë ngushtë të ndërlidhura me sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Në diagramin e mëposhtëm janë paraqitur dokumentet më të rëndësishme strategjike për periudhën 2007-2024.

**Diagrami 4.1** Dokumentet strategjike nga fusha e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Kosovë



<sup>51</sup> Ligji për inspektoratin bujqësor Nr. 03/L-029; Ligji për produktet për mbrojtjen e bimëve Nr. 03/L-042; Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L-026; Ligji për ujitjen e tokës bujqësore Nr. 02/L-009; Ligji për materialet fidanore Nr. 2004/13; Ligji për verërat Nr. 02/L-008; Ligji për veterinarinë Nr. 2004/21; Ligji për blegtorinë Nr. 04/L-191; Ligji për kujdesin ndaj kafshëve Nr. 02/L-010; Ligji për rregullimin e tokave Nr. 04/L-040; Ligji për bujqësinë organike Nr. 04/L-085; Ligji për shërbimet këshillëdhënëse për bujqësi dhe zhvillim rural Nr. 04/L-074, etj.

<sup>52</sup> Ligji për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit Nr. 04/L-175; Ligji për kimikatet Nr. 04/L-197; Ligji për ujërat Nr. 04/L-147; Ligji për mbrojtjen e ajrit Nr. 2004/30; Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233, etj.

<sup>53</sup> Agjencia Evropiane e Mjedisit, Raporti i Gjendjes së Mjedisit, Kosovë 2015, në faqen: <http://bit.ly/2j9nMir>

Marrë parasysh kompaktibilitetin e këtyre dy fushave, standardet e fushës së mjedisit gjithsesi duhet të inkorporohen në politikat zhvillimore të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Prandaj, nuk është befasues fakti që mbrojtja e qëndrueshme e mjedisit përbën një nga caqet kryesore të zhvillimit të bujqësisë dhe zhvillimit rural nën ombrellën e Ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (neni 4). Përveç kësaj, masa që përkrahin mbrojtjen e mjedisit paraqiten në Planin Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe rregullohen me planin përkatës të veprimit.

Kur është në pyetje struktura institucionale, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) është përgjegjëse për zhvillim dhe implementim të politikave nga kjo fushë. Për të krijuar strukturat e domosdoshme administrative në pajtim me Politikën e Përbashkët të Bujqësisë (PPB) të Bashkimit Evropian,<sup>54</sup> dhe për të qenë kompetente për implementim të politikave të IPARD<sup>55</sup> gjatë rrugëtimit të vet drejt BE-së, MBPZHR gjatë viteve të kaluara ka kryer reorganizim strukturor. Në vitin 2013, është krijuar Agjencia për Zhvillim të Bujqësisë (AZHB), e cila merret me realizimin e programit përkrahës për bujqësi dhe zhvillim rural, si edhe Instituti Bujqësor i Kosovës. Me miratimin e Ligjit për sigurinë e ushqimit në vitin 2009 është themeluar edhe Agjencia për Veterinë dhe Ushqim e cila kryen veprimtari ngushtë të lidhur me politikat e BE-së për shëndetësi publike dhe mbrojtje të konsumatorëve. Në nivel lokal, komunat janë përgjegjëse për implementimin e politikave nga fusha e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Në komunat e veriut të Kosovës (Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok dhe Zveçan), autoritetet lokale ende nuk i zbatojnë kompetencat e tyre nga fusha e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Nga ana tjetër, në këto komuna janë të punësuar zyrtarë përgjegjës për realizimin e masave dhe politikave për zhvillimin e bujqësisë nën kornizën e sistemit juridik të Republikës së Serbisë.

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit, institucion përgjegjës në nivel qendror është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Nën ombrellën e kësaj ministrie është themeluar edhe Agjencia e Kosovës për Mbrojtje të Mjedisit, si dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës, e cila është tejet e rëndësishme për fushën e bujqësisë, para së gjithash për shkak të rëndësisë së të dhënave kadastrale për zhvillimin e bujqësisë. Është me rëndësi të theksohet se institucionet kosovare për mbrojtjen e mjedisit nuk funksionojnë në komunat e veriut të Kosovës.

### *Rrugëtimi drejt BE-së*

Disa prej sektorëve më të vështirë në kuptim të harmonizimit të dispozitave ligjore me ato të BE-së janë bujqësia dhe mjedisi, për shkak se për harmonizimin e tyre me dispozitat e BE-së kërkohen investime të cilat tejkalojnë mundësitë e Qeverisë së Kosovës. Fillimi i këtij procesi është përshkruar me probleme të theksuara në kuptim të zbatimit të ligjeve, rregulloreve dhe akteve tjera. Gjithashtu është i theksuar problemi i miratimit të akteve ligjore duke përshkruar rregullativën ligjore nga vendet tjera të BE-së, të cilat shpesh nuk përkojnë me sistemin

<sup>54</sup> Për më shumë lidhur me politikat e përbashkëta bujqësore (Common Agriculture Policy) vizitoni faqen:


<http://bit.ly/2rkPbvA>.

<sup>55</sup> IPARD – Instrumenti për ndihmë paraanëtarësimin në zhvillim rural.


juridik të Kosovës, gjë që pamundëson implementimin e tyre. Përveç kësaj, është e domosdoshme edhe një administratë e fuqishme e cila ka kapacitete për implementim të politikave publike, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Mungon edhe praktika e nxjerrjes së politikave publike në bazë të fakteve, si dhe analiza e efekteve të dispozitave ekzistuese.

Në kontekst të përafrimit me rrjedhat ligjore në BE në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, në imazhet e mëposhtme janë paraqitur niveli i gatishmërisë dhe niveli i zhvillimit të ekonomive të Ballkanit Perëndimor në procesin e integritimit në BE, në bazë të kriterëve të përcaktuara në raportet e progresit për secilin shtet kandidat individualisht.

**Diagrami 4.2** Niveli i gatishmërisë së kandidatëve për anëtarësim në BE nga sektori i bujqësisë dhe zhvillimit rural



*Burimi:* Komisioni Evropian, Raportet e Progresit të vendeve të Ballkanit Perëndimor për vitet 2015 dhe 2016

**Diagrami 4.3** Niveli i përparimit të kandidatëve për anëtarësim në BE në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural

*Burimi:* Komisioni Evropian, Raportet e Progresit të vendeve të Ballkanit Perëndimor për vitet 2015 dhe 2016P  
 PPB luan rol të rëndësishëm për zhvillimin e politikave agrobujqësore në Kosovë në kuptim të rrugëtimit të saj drejt BE-së, prandaj ajo duhet të miratojë një sërë rregullash dhe rregulloresh obligative të rëndësishme për funksionimin e kësaj politike. Caku kryesor i PPB është sigurimi i një standardi jetësor për bujqit, si dhe furnizimi i sigurt dhe stabil i ushqimit, me çmime të përballueshme për të gjithë konsumatorët. Kjo sigurohet përmes ofrimit të përkrahjes për bujqit, promovimit të zhvillimit rural, avancimit të produktivitetit dhe kualitetit të jetës së njerëzve në vise rurale.<sup>56</sup> Duke qenë se Kosova është e pasur me tokë bujqësore, kjo politikë mund të përbëjë rast të mirë për zhvillimin e bujqësisë, fshatrave dhe viseve rurale në të ardhmen. PPB gjithashtu ka rol të theksuar për viset tjera, siç janë mbrojtja e mjedisit, siguria e kafshëve dhe mbrojtja e resurseve natyrore. Me rregullat e PPB sigurohet respektimi i parimeve të mbrojtjes së mjedisit, ndërsa me masat përkatëse të kësaj politike promovohen praktikatat bujqësore të qëndrueshme nga këndvështrimi ekologjik.

Si njëra nga politikat më të mëdha dhe më të rëndësishme të përbashkëta të BE-së, PPB kryesisht financohet nga buxheti i BE-së, edhe atë në masë prej 40%.<sup>57</sup> Ky fakt gjithashtu vë në pah rëndësinë e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural në procesin e përafrimit. Kërkesat e BE-së për Kosovën para së gjithash kanë të bëjnë me krijimin e strukturave institucionale për implementimin e strategjive dhe planeve të veprimit, trupave të fuqishëm administrativë dhe ekzekutivë për implementimin e ligjeve nga kjo sferë dhe ngritjen e kapaciteteve për përpunim adekuat të kërkesave dhe monitorimin e skemave të granteve dhe subvencioneve.

<sup>56</sup> EU & Kosovo – Pasqyrë e politikave kryesore të integritimit evropian, 2014, në faqen: <http://bit.ly/2rV8Vcd>, f. 3.

<sup>57</sup> Shpenzimi në bujqësi në BE, Komisioni Evropian, shtator 2015, në faqen: <http://bit.ly/2rF41Ad>, f. 8.

Kapacitetet për implementimin e ligjeve në nivel kombëtar dhe lokal ende nuk janë në nivel të kënaqshëm, prandaj është me rëndësi të punohet edhe më tej në fuqizimin e tyre.<sup>58</sup> Mungesa e kapaciteteve për implementim të ligjeve është edhe më e theksuar në veri të Kosovës, ku paraqitet edhe problemi i dualitetit të sistemit. Zyrtarët ekzistues komunalë që kryejnë punët në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural punojnë nën kornizat e sistemit të Republikës së Serbisë, e rrjedhimisht e kanë fare pak të njohur sistemin e Kosovës. Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut funksionon ekskluzivisht sipas sistemit të Kosovës, por për shkak të sipërfaqes së vogël të kësaj komune, pothuajse nuk ka fare veprimtari bujqësore,<sup>59</sup> kështu që kërkesat për implementim të ligjeve përkatëse në këtë komunë janë minimale.

#### 4.3 Gjendja e bujqësisë në Kosovë dhe ndikimi i saj në mjedis

Marrë parasysh mbulueshmërinë e madhe me tokë bujqësore, bujqësia e Kosovës përbën nga nga veprimtaritë kryesore ekonomike të vendit. Në vitin 2014 janë shfrytëzuar 413,635ha tokë bujqësore, nga e cila 197,012 ha është shfrytëzuar për kultivim të produkteve bujqësore.<sup>60</sup> Aktualisht, sektori i bujqësisë kontribuon në BPV me vetëm 12% ndërsa në eksport me vetëm 15%.<sup>61</sup>

Sipërfaqja e tokës bujqësore zvogëlohet vazhdimisht për shkak të planifikimit joadekuat hapësinor dhe implementimit të dobët të Ligjit për Tokën Bujqësore, si dhe rregullativës që ndërlidhet me mbrojtjen e tokës dhe ndryshimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore.

Edhe pse ka potencial për zhvillim të bujqësisë, produktet bujqësore vazhdojnë të mbulojnë një pjesë të theksuar të importit, edhe atë në masë prej 24.4%. Në vitin 2011, Serbia ka marrë pjesë me 20% në strukturën e përgjithshme të importit në Kosovë, dhe ka qenë partneri më i madh tregtar i saj.<sup>62</sup> Raporti mes importit dhe eksportit të produkteve bujqësore, si dhe deficitit tregtar i periudhës 2008-2014 është paraqitur në diagramin e mëposhtëm.


<sup>58</sup> EU & Kosovo – Pasqyrë e politikave kryesore të integritit evropian, 2014, në faqen: <http://bit.ly/2rV8Vcd>, f. 3.

<sup>59</sup> Në territorin e komunës së Mitrovicës së Veriut, aktivitetet bujqësore zhvillohen vetëm në fshatin Suvadoll.

<sup>60</sup> Raporti i gjelbër i Kosovës, 2015, në faqen: <http://bit.ly/2rkVeQQ>, f. 24

<sup>61</sup> Programi kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, në faqen: <http://bit.ly/2rUMoff>, f. 168.

<sup>62</sup> Studimi “Tregtimi me produkte bujqësore mes Serbisë dhe Kosovës”, projekti “ReConnexion”, Fondi Hartefakt, 2013.

**Diagrami 4.4** Importi-Eksporti i produkteve bujqësore, në milionë euro, 2008-2015

*Burimet:* Raporti i gjelbër i Kosovës 2015, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agricultural Policy Puls, Kosovë

Sipas regjistrimit të bujqësisë të vitit 2014, në të cilin komunat e veriut të Kosovës refuzuan të marrin pjesë,<sup>63</sup> në Kosovë ekzistojnë 130,775 ekonomi familjare bujqësore, nga të cilat vetëm 339 janë të regjistruara si persona juridikë.<sup>64</sup> Sipas madhësisë së pronave, mbizotërojnë ato me 0.4-2ha sipërfaqe (46.5%),<sup>65</sup> në të cilat zhvillohen veprimtari të cilat kryesisht i plotësojnë nevojat familjare për ushqim. Situata është e ngjashme edhe në komunat në veri të Kosovës, ku pjesa më e madhe e pronave bujqësore (të regjistruara sipas sistemit serb) janë mes 2-5ha.<sup>66</sup>

Zhvillimi i bujqësisë në dekadat e fundit ka sjellë deri tek shfrytëzimi i tepërt i resurseve natyrore, duke neglizhuar parimet themelore ekologjike. Çështja e mbrojtjes së mjedisit është kyçe kur flitet për sektorin e bujqësisë, sepse ai përbën një nga ndotësit më të mëdhenj. Edhe pse mjedisi nuk është tërësisht i inkorporuar në politikat zhvillimore të bujqësisë në Kosovë, ndikimi i aktiviteteve aktuale bujqësore në mjedis është më i ulët se sa në vendet e rajonit.<sup>67</sup> Mjetet mekanike që shfrytëzohen për punë janë kryesisht të lehta, prandaj edhe ndikimi negativ në mjedis dhe biodiversitet është më i ulët se sa ai në shtetet e rajonit. Megjithatë, probleme ka në kuptim të fragmentimit të tokës, ndotjes së tokës dhe ujërave për shkak të shfrytëzimit joadekuat të agrokimikateve (plehrave artificiale dhe pesticideve), erozionit të

<sup>63</sup> Regjistrimi i bujqësisë 2014, në faqen: <http://bit.ly/2snrVN9>, f. 4

<sup>64</sup> Raporti i gjelbër i Kosovës, 2015, në faqen: <http://bit.ly/2rkVeQQ>, f. 25.

<sup>65</sup> FAO, Praktikë më të mira në krijimin e vendeve të gjelbra të punës për sigurimin e qëndrueshmërisë së amvisërive rurale dhe shfrytëzim të resurseve si pjesë e Zhvillimit Rural, 2012, në faqen: <http://bit.ly/2qBqOIZ>, f. 4.

<sup>66</sup> Të dhënat mbi strukturën e pronave bujqësore në veri të Kosovës të regjistruara në sistemin e Kosovës nuk kanë qenë në dispozicion gjatë grumbullimit të të dhënave të hulumtimit.

<sup>67</sup> Ndryshimi dhe plotësimi i Strategjisë për mbrojtjen e mjedisit 2011-2020, në faqen: <http://bit.ly/2rFll82>, f. 31.

tokës, konsolidimit të tokës, etj. Tejkalimi i këtyre problemeve mund të bëhet vetëm me struktura efikase të inspektimit, promovim të bujqësisë organike, zgjidhje të problemit të ndërrimit të destinimit të tokës, edukim të bujqve, do të thotë me krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës dhe funksional për këtë fushë.

Praktikat aktuale në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural paraqesin burim të madh të ndotjes së mjedisit, prandaj është e domosdoshme që të njëjtat të modifikohen dhe orientohen drejt bujqësisë organike, e cila mundëson jo vetëm prodhimin e ushqimit ekologjik dhe të shëndetshëm por edhe mbrojtjen e resurseve natyrore. Zhvillimi i bujqësisë organike në Kosovë është në zanafillë. Nën ombrellën e MBPZHR që nga viti 2010 funksionon edhe Njësia për Bujqësi Organike, ndërsa që në vitin 2002 është themeluar edhe Asociacioni i Bujqve Organikë të Kosovës. Qëllimi kryesor i këtij Asociacioni është paraqitja e metodave organike dhe edukimi i bujqve, por edhe krijimi i standardeve dhe akteve ligjore. Në planin e zhvillimit të bujqësisë dhe zhvillimit rural për periudhën 2014-2020 theks i veçantë i është vënë zhvillimit të bujqësisë organike. Është krijuar edhe skema e bujqësisë organike dhe i është dhënë përparësi fermerëve organikë kur është në pyetje skema e përkrahjes investive. Edhe pse Ligji për Bujqësinë Organike<sup>68</sup> është miratuar që në vitin 2008 (e është ndryshuar në vitin 2012), implementimi i tij mbetet në nivel të ulët, ndërsa krijimi i organeve dhe komisioneve përkatëse për prodhimtari organike brenda MBPZHR nuk ka filluar ende.<sup>69</sup> Ky ligj pjesërisht është i harmonizuar me rregullativën e BE-së. Pjesa më e madhe e bujqve dëshiron të intensifikon prodhimtarinë, prandaj shfrytëzon plehra e pesticide pa kontroll dhe pa marrë parasysh ndikimin e mundshëm negativ mbi mjedisin dhe shëndetin njerëzor. Ekziston një numër i vogël i bujqve që përpiqen të prodhojnë në mënyrë ekologjike, duke e ruajtur biodiversitetin dhe të cilët janë kundër shfrytëzimit të agrokimikateve. Për momentin, një numër i vogël i bujqve në Kosovë janë në fazë të kalimit në bujqësi organike,<sup>70</sup> ndërsa është vlerësuar se rreth 85 hektarë janë nën konvertim (16 lloje që eksportohen si produkte të certifikuar organike).<sup>71</sup> Në masë më të madhe ky eksport mbulohet nga bimët mjekësore, të cilat mbulojnë 58 hektarë.<sup>72</sup> Një nga pengesat kryesore në kuptim të bujqësisë organike është certifikimi i produkteve. Në Kosovë nuk ekziston organi për certifikimin e produkteve organike, prandaj për këtë qëllim angazhohen ndërmarrjet nga Shqipëria (Albinspekt) dhe Maqedonisë (Procert), të cilat ofrojnë shërbime të tilla. Duke qenë se në treg janë të pranishëm kryesisht prodhues të vegjël, ka mundësi të certifikimit grupor gjë që e bën të domosdoshëm bashkimin e bujqve për këtë qëllim.

Kur bëhet fjalë për bashkëpunimin mes bujqve, në Kosovë bashkimi në kooperativa ende vazhdon të jetë në nivel të ulët. Sipas Ligjit Nr. 03/L-044 për ndryshimin dhe plotësimin e

<sup>68</sup> Ligji për bujqësinë organike është pjesërisht i harmonizuar me rregulloret e BE-së Nr. 834/2007 dhe Nr. 889/2008, Programi kombëtar për implementimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, mars 2016., në faqen: <http://bit.ly/2rUMofF>, str. 159.

<sup>69</sup> Raporti i Progresit të Kosovës, BE, 2015, në faqen: <http://bit.ly/2rbTlrm>, f. 48.

<sup>70</sup> Periudha e konvertimit (kalimit) nënkupton kohën e domosdoshme për kalim nga sistemet tjera të prodhimit në sistem të prodhimit organik. Asociacioni i bujqve organikë të Kosovës (OAAK) ka përkrahur konvertimin e një numri të caktuar të bujqve.


<sup>71</sup> Zhvillimi Ekonomik i Bujqësisë Organike të Kosovës. Vlerësimi i Parë, Dhjetor 2013, në faqen: <http://bit.ly/2sewmdz>, f. 3.

<sup>72</sup> Programi kombëtar për implementimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, mars 2016, në faqen: <http://bit.ly/2rUMofF>, f. 173.

Ligjit Nr. 2003/9 për kooperativat bujqësore, respektivisht nenit 3 të të njëjtit, kooperativa mund të themelohet nga së paku 5 bujq, ndërsa më pas unioni mund të krijohet me bashkimin e dy apo më shumë kooperativave. Edhe pse ato sjellin përfitime të shumta, siç janë krijimi i vendeve të reja të punës, qasja në teknologji, pozita më e mirë negociuese me furnitorë, tregtarë dhe banka, apo intensifikimi i konkurrencës, numri i kooperativave efektive është i vogël. Deri tani në Kosovë janë regjistruar 83 kooperativa, ndërsa në veri të Kosovës janë tri sish – në Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan.

Viteve të fundit është evidente rritja e investimeve në fushë e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Me qëllim të avancimit të bujqësisë, Qeveria e Kosovës ndanë mjete të konsiderueshme – në vitin 2015 për grante janë ndarë 20 milionë euro,<sup>73</sup> ndërsa në vitin 2016 janë ndarë 23 milionë.<sup>74</sup> Gjithashtu, Qeveria, me pagesa direkte dhe grante, u ofron bujqve përkrahje nën kornizën e masave për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural në Kosovë, ndërsa përkrahja financiare është shumëfishuar viteve të fundit (diagrami 3). Në vitin 2016 dhe 2015, për pagesa direkte janë ndarë nga 23 milionë euro, që përbën rritje të theksuar në krahasim me vitin 2014.<sup>75</sup>

**Diagrami 4.5** Pagesat direkte, në mijëra euro, 2011-2016



*Burimi:* Raporti i gjelbërt i Kosovës 2015, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; dhe Raporti i Progresit të Kosovës për vitin 2016, Komisioni Evropian

Viteve të fundit organizatat ndërkombëtare, para së gjithash BE dhe të tjera, kanë përkrahur konsiderueshëm sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, përmes ofrimit të asistencës teknike për ngritje të kapaciteteve në institucione, ndarje të granteve për bujq, dhe programe për krijimin e mundësive të zhvillimit. Nga viti 2000, BE ka ndarë rreth 100 milionë euro për ta përkrahur këtë sektor në Kosovë.<sup>76</sup> Që nga viti 2007, Kosova shfrytëzon fondet IPA të BE-

<sup>73</sup> Raporti i Progresit të Kosovës 2015, BE, në faqen <http://bit.ly/2rbTlrm>, f. 48.

<sup>74</sup> Raporti i Progresit të Kosovës 2016, BE, në faqen: <http://bit.ly/2jzj89G>, f. 55.

<sup>75</sup> Raporti i Progresit të Kosovës 2016, BE, në faqen: <http://bit.ly/2jzj89G>, f. 55.

<sup>76</sup> EU & Kosovo – Pasqyrë e politikave kryesore të integritimit evropian, 2014, në faqen: <http://bit.ly/2rV8Vcd>, f. 6.



së<sup>77</sup> (IPA 2007-2013 dhe IPA 2014-2020). Megjithatë, Kosova ende nuk posedon kapacitete të mjaftueshme për ta implementuar komponentin e IPA që ndërlidhet me bujqësinë dhe zhvillimin rural – IPARD. Çak i IPARD-it, sipas Komisionit Evropian, është që të ofrojë ndihmë në implementimin e rregullave të BE-së dhe standardeve që kanë të bëjnë me politikat e përbashkëta të bujqësisë, si dhe t'i kontribuojë zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural në shtetet candidate.<sup>78</sup> Kosova duhet të përpiqet të krijojë strukturat e domosdoshme dhe të zhvillojë kapacitetet për të implementuar IPARD.<sup>79</sup> Një kontribut i madh i BE-së ka të bëjë me hapjen e tregut evropian edhe për produkte bujqësore të Kosovës. Në vitin 2007 ka hyrë në fuqi marrëveshja e CEFTA-s, e cila ka hapur mundësi të reja për bujqit e këtij territori. Përveç BE-së edhe donatorë tjerë, siç janë Banka Botërore, Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e Danimarkës (DANIDA), USAID, Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e Austrisë (ADA), GIZ-i dhe të tjerë investojnë mjete të konsiderueshme në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Kosovë. Përveç kësaj, kujdes i veçantë i kushtohet mjedisit jetësor përmes realizimit të projekteve të ndryshme.

#### 4.4 Përse bujqësia (nuk) përbën mundësi zhvillimi për veriut të Kosovës?

Bujqësia në veriun e Kosovës dallon mes viseve kodrinoro-malore në të cilat dominon blegtoria dhe rajonit të luginës së lumit Ibër ku kryesisht zhvillohet pemëtaria, perimtaria dhe kultivimi i drithërave. Megjithatë, të rrallë janë shembujt e ndërmarrjeve të suksesshme apo amvisërive bujqësore në këtë sektor. Arsyt kryesore për konkurrueshmërinë e ulët të bujqve nga ky rajon janë tregu i vogël, mungesa e informatave për tregun, parcelat e vogla, prodhimtaria e zgjatur, mekanizmat e vjetërsuar, mungesa e mjeteve financiare për blerje të mekanizmave më modernë, si dhe ekzistimi i pengesave të ndryshme administrative. Problem themelor është ngopja, respektivisht fragmentimi i tokave, gjë që përbën pengesë për prodhim të qëndrueshëm të produkteve bujqësore, shfrytëzim rentabil të mekanizmave modernë si dhe zvogëlimin e shpenzimeve të prodhimtarisë. Përveç ndikimit në konkurrueshmërinë e bujqve dhe zhvillimin ekonomik, fragmentimi i tokave ndikon edhe në mjedisin njerëzor.

Korniza ligjore në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural aktualisht nuk ofron mekanizma për mbikëqyrje, praktika të qëndrueshme për grumbullim të produkteve bujqësore, leje për grumbullim apo kuota për grumbullim që duhet të sigurojnë mbrojtjen e biodiversitetit (diversitetit biologjik) në rajon.<sup>80</sup> Ndotja e tokës dhe ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore si rrjedhojë e shfrytëzimit joadekuat të agrokimikateve, prerja e pakontrolluar e pyjeve që sjell deri tek erozioni i tokës, ndotja e ajrit për shkak të emetimit të gazrave në mjedis nga stallat, janë vetëm disa nga faktorët kufizues të zhvillimit të këtij sektori në veri të Kosovës. Ende nuk ekzistojnë shërbime efikase të inspektimit. Në bazë të Ligjit për inspektoratin bujqësor Nr. 03/L-029, respektivisht nenit 5 të tij, kontrolli inspektues kryhet nga inspektorë të nivelit

<sup>77</sup> IPA – Instrumenti për asistencë paraanëtarësimit shteteve candidate për BE, si dhe shteteve candidate potenciale për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

<sup>78</sup> EU & Kosovo – Pasqyrë e politikave kryesore të integritimit evropian, 2014, në faqen: <http://bit.ly/2rV8Vcd>, f. 6.

<sup>79</sup> Fuqizimi i akterëve ruralë në Ballkanin Perëndimor, Komisioni Evropian, 2014, në faqen: <http://bit.ly/2qGHnCl>, f. 43.

<sup>80</sup> Analiza e zinxhirit të vlerave – produktet jodrusore në pyje, Rajoni i Mitrovicës, UNDP, 2015.

qendror në tërë territorin e Kosovës, ndërsa inspektorët komunalë kryejnë inspektimin brenda territorit të komunës, në pajtim me kompetencat ligjore. Duke qenë se nuk ekzistojnë inspektorate bujqësore pranë autoriteteve lokale në veri të Kosovës, nuk mund të zbatohen as sanksione për ata që shkelin ligjin.

Kur është në pyetje zhvillimi i bujqësisë organike, kërkesa për produkte organike në tregun evropian është në rritje konstante, por edhe kërkesat në kuptim të cilësisë së produkteve janë në rritje, gjë që paraqet sfidë për bujqit e rajonit. Potencial sigurisht se ka duke qenë se shumica e tokave janë me sipërfaqe të vogla dhe gjenden në lartësi të mëdha mbidetare, të cilat janë të përshtatshme në veçanti për zhvillimin e bujqësisë organike, ndërsa për këtë fushë ndahen edhe mjete të konsiderueshme financiare. Megjithatë, mosekzistimi i organeve inspektuese dhe certifikuese të produkteve organike e vështirëson sigurimin e produkteve të cilësisë së lartë. Pa marrë parasysh faktin se struktura institucionale për zhvillim të bujqësisë organike në nivel kombëtar veç është themeluar, promovimi i kësaj dege të bujqësisë është e pamjaftueshme, dhe vetëm një numër i vogël i bujqve merret aktualisht me prodhimtari organike. Ajo që duhet theksuar kur shqyrtohet potenciali i kësaj dege është arsyeshmëria ekonomike e prodhimit të produkteve organike në Kosovë kundrejt produkteve konvencionale. Shtrohet edhe pyetja nëse mund të pritet që shpenzimet më të larta dhe hyrjet më të ulëta të kompensohen, respektivisht nëse fuqia blerëse dhe vetëdija e popullatës lidhur me përdorimin e ushqimit ekologjikisht të pastër është e tillë që kjo degë e bujqësisë të jetë fitimprurëse. Relacioni mes fitimit dhe shpenzimeve në prodhimtari organike nuk është i ditur për prodhuesit bujqësorë.

Një nga parakushtet themelore për zhvillim të bujqësisë është infrastruktura adekuate, e cila përfshin sistemin e ujitjes dhe objektet për përpunim dhe depozitim të korrjeve. Vërehet se në veri të Kosovës mungojnë objekte të tilla moderne. Vjetërsimi i mekanizmave paraqet problem të madh për bujqit dhe një nga arsyt kryesore për produktivitet të ulët dhe ekonimizim më të ulët të prodhimtarisë bujqësore atje. Ekzistojnë disa ndërmarrje në komunat e Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut që posedojnë pajisje më moderne për përpunim të pemëve dhe perimeve, si dhe për prodhimin e qumështit dhe produkteve të qumështit. Në komunën e Leposaviqit ekzistojnë tri komuna që merren me blerjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve, ndërsa një e tillë ekziston në Zubin Potok. Nga shtatori i vitit 2015 për blerje të tërë rendimentit paguhet edhe taksa prej 3% nga vlera e gjithmbarshme, ndërsa për plasman të produktit në treg duhet të kryhet analiza në Entin e Shëndetit Publik të Prishtinës, me seli në Mitrovicë, i cili funksionon në bazë të sistemit të Republikës së Serbisë. Përveç kësaj, tatimet dhe taksat doganore që paguhen me rastin e eksportit edhe më tej rritin shpenzimet e prodhuesve dhe përpunuesve. Kur është në pyetje eksporti në Republikën e Serbisë, paraqiten edhe disa probleme lidhur me eksportin e pyjeve të malit, për shkak të mosharmonizimit të dokumentacionit të nevojshëm për procedura doganore mes Serbisë dhe Kosovës, ndërsa eksporti i pemëve nga plantacionet bëhet pa problem. Viteve të fundit në veri të Kosovës është në trend edhe kultivimi i pemëve të vogla, në veçanti mjedrave, por edhe produkteve nga serrat. Edhe blegtoria është degë e popullarizuar e bujqësisë, e cila karakterizohet me ekonomi familjare të vogla, e që për cak ka kryesisht përbushjen e nevojave të ekonomisë familjare, ndërsa një pjesë fare e vogël destinohet për plasman në treg.

Qasja në fondet që ofrohen nga Qeveria e Kosovës dhe e Serbisë, si dhe donatorët ndërkombëtarë, mund të bëhet vetëm pas regjistrimit të ekonomisë familjare. Për këtë qëllim, bujqit nga veriu i Kosovës mund të regjistrohen edhe në sistemin serb edhe atë kosovar. Regjistrimi i ekonomive familjare në sistemin e Kosovës për bujqit e veriut të Kosovës bëhet pranë Zyrës Administrative të Mitrovicës së Veriut dhe në Prishtinë, pranë Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës. Në sistemin serb janë të regjistruara gjithsej 3139 ekonomi familjare bujqësore, nga të cilat numri më i madh është i regjistruar në komunën e Leposaviqit (1811). Zubin Potoku është komunë në të cilën banorët kryesisht merren me bujqësi, prandaj ky sektor edhe trajtohet si potencial për zhvillim ekonomik<sup>81</sup> (për momentin ka të regjistruara 414 ekonomi familjare bujqësore). Në komunën e Zveçanit viteve të fundit bujqësia i është nënshtruar industrializmit edhe pothuajse është shuar fare. Sot, më shumë se gjysma e ndërmarrjeve të regjistruara (53%) janë tregtare, ndërsa prodhimtaria bujqësore ka përqindje të ulët, kryesisht në fushën e kultivimit të perimeve për shitje.<sup>82</sup> Në territorin e komunës së Mitrovicës së Veriut ka shumë pak sipërfaqe bujqësore dhe në këtë komunë potenciali i zhvillimit të bujqësisë është i vogël.

Një nga donatorët më të mëdhenj që e ka përkrahur sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural në veri të Kosovës është Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Në periudhën mes vitit 2010 dhe 2015, BE përmes disa programeve (EURED III, skema e granteve për veri I dhe II) i ka ndarë rreth 3.1 milionë euro për këtë sektor. Vetëm nën kornizën e skemave të granteve për veriun I dhe II janë financuar 79 projekte për komunat e veriut,<sup>83</sup> nga të cilat 44 projekte kanë qenë nga fusha e zhvillimit të bujqësisë dhe zhvillimit rural.<sup>84</sup> Ndarja e projekteve sipas komunave është paraqitur në tabelën në vijim.

**Tabela 4.1** Ndarja e projekteve për zhvillim të bujqësisë në veri të Kosovës

| Komuna                    | Numri i gjithmbarshëm i projekteve të përkrahura në GS I dhe GS II | Numri i projekteve për zhvillim të bujqësisë në GS I dhe GS II | Projekte për zhvillim të bujqësisë (në përqindje) |
|---------------------------|--|--|---|
| <b>Mitrovica e Veriut</b> | 19   | 2  | 10,5%   |
| <b>Zveçani</b>            | 16   | 8  | 50%   |
| <b>Zubin Potoku</b>       | 12   | 10   | 83,4%   |
| <b>Leposaviqi</b>         | 29   | 24   | 82,7%   |

*Burimi:* Studimi „A po jetojmë më mirë“, InTER, 2016.

<sup>81</sup> Strategjia për zhvillimin e komunës Zubin Potok, në faqen: <http://bit.ly/2rkMuKQ>, f. 25.

<sup>82</sup> Faqja zyrtare e komunës së Zveçanit në internet, në: <http://bit.ly/2rl5Orf>.

<sup>83</sup> Nga gjithsej 79 projekte të miratuara nën kornizat e SG I dhe SG II, tri projekte janë ndërkomunale dhe nuk kanë të bëjnë me zhvillimin e bujqësisë.

<sup>84</sup> Studimi „A po jetojmë më mirë“, InTER, 2016, në faqen: [bit.ly/2dGo1rR](http://bit.ly/2dGo1rR), f. 47.

Përveç ndihmës financiare nga donatorë të ndryshëm, në veri të Kosovës pothuajse nuk ka lloje tjera të përkrahjes. Miratimi i kredive bujqësore në banka nuk aplikohet fare. Sipas studimit të UNDP të kryer në vitin 2015, edhe pse në veri të Kosovës funksionojnë disa banka, kredi për bujqësi nuk jepen sepse pagesat nuk janë të siguruara, garancitë e kompanive nuk janë të regjistruara fare në institucionet e Kosovës, sundimi i ligjit dhe puna e organeve gjyqësore janë në nivel të pamjaftueshëm.<sup>85</sup> Përveç kësaj, mosdisponueshmëria dhe paqëndrueshmëria e të dhënave në sektorin e bujqësisë ia bëjnë edhe më të vështirë institucioneve financiare vlerësimin e gjendjes në këtë sektor, andaj ai konsiderohet si shumë i rrezikshëm për investime. Ajo me çka do të hapeshin më shumë mundësi për bujqit është formimi i asociacioneve, me çka do të lehtësohej tërë procesi dhe do të sigurohej qasje në më shumë mjete, pajisje më moderne dhe më shumë vende pune.

Problemet e cekura shpërfaqin domosdoshmërinë e ndërmarjes së masave konkrete, si nga ana e autoriteteve qendrore ashtu edhe nga ato lokale, të cilat do të sigurojnë qëndrueshmërinë e sektorit të bujqësisë në Kosovë. Përveç kësaj, duhet të bëhen përpjekje shtesë për të zvogëluar ndikimi negativ i veprimtarisë bujqësore në mjedisin jetësor, duke qenë se bujqësia është një nga ndotësit më të mëdhenj të mjedisit.

#### 4.5 Përfundimet dhe rekomandimet

Si aktiviteti kryesor ekonomik i Kosovës, bujqësia paraqet potencial të madh për zhvillim. Asaj i shkojnë për shtati edhe investimet çdo herë e më të mëdha në këtë sektor gjatë viteve të fundit, si nga ana e Qeverisë së Kosovës ashtu edhe nga organizatat ndërkombëtare dhe bilaterale.

Institucionet e Kosovës janë të fokusuara në harmonizimin e legjislacionit nga fusha e bujqësisë dhe zhvillimit rural me rrjedhat në BE, por për këtë proces nevojiten më shumë përpjekje. Problem i veçantë është miratimi i shpejtë i ligjeve, pa kryerje të analizave të detajuara të efekteve të normave ligjore, gjë që rezulton me implementim joefikas të tyre. Kapacitetet për implementimin e ligjeve në nivel lokal dhe nacional nuk janë të mjaftueshme, ndërsa problem i veçantë për veriuin e Kosovës është edhe dualiteti i sistemit. Zyrtarët komunalë për bujqësi dhe zhvillim rural punojnë nën kornizën e Republikës së Serbisë dhe kanë shumë pak njohuri për ligjet e Kosovës nga kjo fushë.

Ndikimi i bujqësisë në mjedis është i madh, duke qenë se bujqësia është njëri nga ndotësit më të mëdhenj. Agrokimiketat përdoren përtej çdo mase, ndërsa nuk ekzistojnë ende shërbime efikase të inspektimit. Zhvillimi i bujqësisë organike është në faza të hershme dhe janë të nevojshme angazhime shtesë për të ngritur vetëdijen lidhur me prodhimin dhe përdorimin e ushqimeve të prodhuara në bazë të parimeve ekologjike.

Në bazë të analizës dhe përfundimeve mund të nxirren rekomandimet në vijim:

- Të ngriten kapacitetet institucionale dhe organizative për implementimin e politikave publike në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural në nivel lokal, gjë që gjithashtu përfshin ngritjen e efikasitetit të shërbimeve të inspektoratit;

<sup>85</sup> Analiza e zinxhirit të vlerave – Produktet jodrusore në pyje, Rajoni i Mitrovicës, UNDP 2015.

- Të bëhet dallimi mes politikave publike që kanë për synim prodhuesit e vegjël dhe atyre që kanë për synim prodhuesit e mëdhenj bujqësor;
- Të fuqizohen mekanizmat për zhvillim të prodhimtarisë organike, përfshirë edhe themelimin e organeve certifikuese dhe vendosjen e standardeve;
- Të promovohen politika publike në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural në komunat në veri të Kosovës.

# Bujqësia dhe mjedisi në Kosovë

Dy të tretat e të gjitha rregulloreve të BE-së kanë të bëjnë me bujqësinë dhe mjedisin



Rritja e investimeve në zhvillimin e bujqësisë në Kosovë

|       | Qeveria e Kosovë  | Donatorët ndërkombëtarë |
|-------|-------------------|-------------------------|
| 2007. | ~ 6 milionë euro  | ~ 300,000 euro          |
| 2013. | ~ 31 milionë euro | ~ 3 milionë euro        |
| 2015. | ~ 43 milionë euro | ~ 11 milionë euro       |



Bujqësia dhe mjedisi

Mjedisi nuk është i inkorporuar në tërësi në politikat e zhvillimit bujqësor, ndonëse bujqësia është një nga ndotësit më të mëdhenj të tij



Makineria e vjetruar bujqësore dhe niveli i ulët i zhvillimit të bujqësisë

Ndikimi negativ në mjedis më i ulët se ai në vendet fqinje

Mundësi për zhvillimin e bujqësisë organike



Janë miratuar ligje të reja dhe akte të tjera nënligjore me qëllim të harmonizimit me *acquis communautaire* të BE-së

Është krijuar struktura institucionale për zbatimin e politikave publike në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural



Zbatim i pamjaftueshëm i ligjeve

Mungesë e analizës së detajuar të ndikimit rregullativ dhe vlerësimit të politikave publike

Numër i pamjaftueshëm dhe nivel i ulët i kuadrit të kualifikuar



## 5 UJËRAT NË KOSOVË

### 5.1 Hyrje

Mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i resurseve ujore në Kosovë janë disa prej sfidave më të mëdha me të cilat përballen autoritetet lokale. Përkrah faktit që qytetarët disa vite me radhë përballen me mungesa serioze të ujit, është i pranishëm edhe problemi i ndotjes së resurseve ujore. Kjo situatë në masë të gjerë ndikon në cilësinë e jetës së qytetarëve dhe degradimin çdo herë e më të madh të mjedisit, por edhe në zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës.

Uji është faktor i rëndësishëm për zhvillimin e shumë sektorëve tjerë, siç janë bujqësia, energjia, turizmi, xehetaria. Krahas zhvillimit ekonomik rritet edhe kërkesa për ujë dhe presioni mbi mjedisin jetësor, gjë që rezulton me sfida në kuptim të cilësisë së ujit.

Qeveria e Kosovës e kupton rëndësinë e mbrojtjes së ujit, si njërit nga resurset më thelbësore për zhvillimin socio-ekonomik të vendit, prandaj ujërat i ka trajtuar si një nga prioritetet e veta për periudhën 2013-2023.<sup>86</sup> Megjithatë, nuk ka ndonjë përparim të theksuar kur janë në pyetje mbrojtja dhe furnizimi i ujit, në veçanti në zona rurale.

Kjo analizë e shkurtër trajton legjislacionin në fuqi dhe gjendjen aktuale të ujërave në Kosovë, si dhe nivelin e ndotjes së resurseve ujore.

### 5.2 Korniza ligjore dhe legjislative

Përgjatë disa viteve të fundit, në Kosovë është duke u realizuar procesi i adaptimit të standardeve të Bashkimit Evropian, në fushën e mjedisit, përfshirë këtu edhe sektorin e ujërave. Është arritur një përparim i caktuar dhe janë miratuar akte të shumta ligjore dhe nënligjore, si dhe dokumente strategjike që mbulojnë këtë fushë.

Ligji për Ujërat (Nr. 04/L-147) është akti ligjor më i rëndësishëm me të cilin rregullohet shfrytëzimi i resurseve ujore të nevojshëm për shëndetësi publike, mbrojtje të mjedisit dhe zhvillim socio-ekonomik në Kosovë. Gjithashtu, objektivat kryesore e përkufizuara në nenin 1 të këtij ligji janë mbrojtja e resurseve ujore nga ndotja dhe shfrytëzimi i tepërt, krijimi i procedurave për shpërndarje optimale të resurseve ujore si dhe përcaktimi i strukturës institucionale për menaxhim të ujërave. Në fuqi janë edhe ligje tjera të rëndësishme për këtë fushë: Ligji për rregullimin e shërbimeve ujore (Nr. 05/L-042)<sup>87</sup>, Ligji për shëndetin publik (Nr. 02/L-078)<sup>88</sup>, Ligji për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës (Nr. 04/L-232)<sup>89</sup>, Ligji për aktivitetin hidrometeorologjik (Nr. 02/L-079)<sup>90</sup>, Ligji për energjinë (Nr. 05/L-081)<sup>91</sup>, Ligji për eficientësinë e energjisë (Nr. 04/L-016) dhe ligje tjera nga sfera e mbrojtjes së mjedisit dhe bujqësisë që janë ngushtë të lidhura me sektorin e ujërave, siç janë Ligji për mbrojtjen e

<sup>86</sup> Dokumenti politik Qeveritar mbi Ujërat, Këshilli Ndërmintor i Ujërave, në faqen <http://bit.ly/2rFICrG>, f. 3.

<sup>87</sup> Ligji për rregullimin e shërbimeve ujore, Nr. 05/L-042, në faqen <http://bit.ly/2q0HLi>

<sup>88</sup> Ligji për Shëndetësinë Publike Nr. 02/L-78, në faqen <http://bit.ly/2qBLErN>

<sup>89</sup> Ligji për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës Nr. 04/L-232, në faqen <http://bit.ly/2rFbgYM>

<sup>90</sup> Ligji për veprimtarinë hidrometeorologjike Nr. 02/L-79, në faqen <http://bit.ly/2qGXtfj>

<sup>91</sup> Ligji për energjinë, Nr. 05/L-081, në faqen <http://bit.ly/2qBGkVp>

mjedisit (Nr. 03/L-025),<sup>92</sup> Ligji për mbrojtjen e natyrës (Nr. 03/L-233),<sup>93</sup> Ligji për ujitjen e tokave bujqësore (Nr. 02/L-009)<sup>94</sup> dhe shumë të tjerë.

Përveç legjislacionit primar janë bërë përpjekje edhe për hartimin e legjislacionit sekondar. Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), me ndihmë nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, ka hartuar Strategjinë Nacionale për Ujërat, për periudhën 2015-2034, e cila ende nuk është miratuar nga Kuvendi. Strategjia paraqet dokumentin themelor me të cilin identifikohen caqet strategjike dhe orientimet zhvillimore të resurseve ujore në Kosovë për një periudhë 20-vjeçare. Implementimi i strategjisë do të realizohet përmes Planit të Veprimit dhe Investimeve në Ujëra 2015-2034, në të cilin identifikohen projektet prioritare në nivel afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, si dhe përmes Planit për Menaxhim të Shtretërve të Lumenjve 2015-2034. Sipas Raportit të Progresit të Kosovës të hartuar nga Komisioni Evropian për vitin 2016, urgjent duhet të themelohet organi përgjegjës për menaxhim të lumenjve, në mënyrë që të fillohet me hartimin e planeve për menaxhim të shtretërve të lumenjve. Përveç strategjisë për ujërat, janë hartuar edhe Strategjia për Menaxhimin e Sistemeve Ujore Rurale, Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit 2011-2020, Strategjia për Ndryshime Klimatike 2014-2024, si dhe shumë dokumente strategjike tjera të rëndësishme për sektorin e ujërave.

Në Kosovë gjatë disa viteve të fundit është krijuar edhe struktura institucionale për fushën e mbrojtjes së mjedisit, përfshirë sektorin e ujërave. Ministria për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Planifikimin Hapësinor është institucioni kryesor i nivelit qendror, përgjegjës për hartimin dhe implementimin e politikave nga sektori i ujërave, menaxhimin e resurseve ujore dhe koordinimin e rrjedhave të lumenjve. Me ligjin e vitit 2008 është krijuar Këshilli Ministror për Ujëra, me të cilin udhëheq Kryeministri i Kosovës, e anëtarë të së cilit janë ministrat e linjës. Ky këshill përbën organin përgjegjës për marrje të vendimeve në lidhje me çështjet sistemike nga sektori i ujërave, respektivisht propozon masa për zhvillim, shfrytëzim dhe mbrojtje të resurseve ujore. Prandaj, është e qartë se për sektorin e ujërave është e domosdoshme edhe puna e shumë institucioneve tjera, siç janë Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Ministria e Financave (MF), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MALS), Agjencia e Kosovës për Mbrojtje të Mjedisit, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, etj. Mbikëqyrja e ujërave të lumenjve në territorin e Kosovës kryhet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, i cili punon nën ombrellën e MMPH-së. Është krijuar edhe organi për shërbime të furnizimit me ujë, rregullatori i pavarur ekonomik përgjegjës për licencim të ndërmarrjeve publike që ofrojnë shërbime të furnizimit me ujë dhe kanalizimit dhe për caktimin e tarifave.


Në nivel lokal, komunat janë institucione përgjegjëse për lëshimin e lejeve në pajtim me aktet nënligjore që rregullojnë lejet ujore dhe përgjegjësitë përkatëse, të nxjerra nga MMPH, mbrojtjen nga përmbytjet, erozioni dhe katastrofat tjera, menaxhimin e objekteve për rregullim të rrjedhave në mjedise urbane, etj. Përveç kësaj, sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040) komunat kanë kompetenca për sigurimin e shërbimeve të ujësjellësit, të cilat i realizojnë përmes lidhjes së marrëveshjeve me kompanitë e ujësjellësit rajonal.

<sup>92</sup> Ligji për mbrojtjen e mjedisit Nr. 03/L-025, në faqen <http://bit.ly/2k0hcnt>.

<sup>93</sup> Ligji për mbrojtjen e natyrës, Nr. 03/L-233, në faqen <http://bit.ly/2rFsNjK>.

<sup>94</sup> Ligji për ujitjen e tokave bujqësore Nr. 02/L-9, në faqen <http://bit.ly/2snL9Cg>.



**Imazhi 5.1** Korniza institucionale për menaxhim të ujërave në Kosovë

*Burimi:* “Zgjerimi dhe siguri i furnizimit të shërbimeve të ujit të pijshëm në zona rurale në Kosovë”, Qeveria e Kosovës dhe Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë

### *Një hap drejt BE-së, apo jo?*

Një nga caqet e Strategjisë Kombëtare të Ujërave 2015-2034 është “arritja e pajtueshmërisë afatgjatë me dispozitat e Bashkimit Evropian në sektorin e ujërave, fillimisht përmes vendosjes së sistemeve kompatible legjislative dhe planifikimit, e më pas hap pas hapi përmes implementimit praktik të masave të definuara”. Korniza ligjore në sektorin e ujërave është plotësuar në vitin 2013 me miratimin e Ligjit për Ujërat, me të cilin pjesërisht është transponuar Direktiva Kornizë për Ujërat 2000/60/EC. Megjithatë, harmonizimi me direktivat tjera të rëndësishme gjendet në fazë fillestare, ndërsa spikatë problemi i implementimit joefikas të akteve ligjore, nënligjore dhe akteve tjera. Përqindja e harmonizimit të legjislacionit të Kosovës me direktivat tjera të rëndësishme të BE-së nga sfera e ujërave është paraqitur në tabelën në vijim:

**Tabela 5.1** Harmonizimi i legjislacionit të Kosovës me direktivat e Bashkimit Evropian (2015)

| Nr. | Direktiva e Bashkimit Evropian  | Harmonizimi i legjislacionit kosovar (%) |
|-----|---|--|
| 1.  | Direktiva Kornizë për Ujërat 2000/60/EC   | 49%                                      |
| 2.  | Direktiva (91/271/EEC) për trajtimin e ujërave të zeza urbane   | 44%                                      |
| 3.  | Direktiva (98/83/EC) për cilësinë e ujit për pije   | 87%                                      |
| 4.  | Direktiva (91/676/EEC) për nitratet nga burimet bujqësore   | 25%                                      |
| 5.  | Direktiva (2006/7/EC) për cilësinë e ujit për larje   | 0%                                       |
| 6.  | Direktiva (2008/105 EC) për standardet e cilësisë së mjedisit nga fusha e ujërave                       | 4%                                       |
| 7.  | Direktiva (2009/90 EC) për specifikacionet teknike për analiza kimike dhe monitorim të statusit të ujit | 12%                                      |
| 8.  | Direktiva (2006/118/EC) për mbrojtjen e ujërave nëntokësore   | 36%                                      |

*Burimi:* Raporti për gjendjen e ujërave 2015

Duhet theksuar edhe se legjislacioni nga fusha e bujqësisë është shumë i rëndësishëm për sektorin e ujërave, ndërsa harmonizimi i disa ligjeve të caktuara me rrjedhat ligjore të BE-së nuk ka lëvizur shumë. Kësisoj, Ligji për ujitjen e tokave bujqësore (Nr. 02/L-9), Ligji për ndryshimin e ligjit për ujitjen e tokave bujqësore (Nr. 03/L-198) dhe Ligji për peshkatarinë dhe akuakulturën (Nr. 02/L-85) edhe më tej vazhdojnë të mos jenë të harmonizuar me legjislacionin e BE-së. Implementimi i të gjitha udhëzimeve administrative relevante për sektorin e ujërave, të cilat do ta afrojnë legjislacionin e Kosovës me Acquis Communautaire të Bashkimit Evropian, kërkon investime të mëdha që aktualisht sigurohen ose nga buxheti i Qeverisë së Kosovës ose nga përkrahja e donatorëve.

### 5.3 Gjendja aktuale në sektorin e ujërave

Për shkak të rëndësisë së paçmueshme për mbijetesën e të gjitha gjallesave, por edhe si faktor i rëndësishëm për zhvillimin socioekonomik, menaxhimi dhe mbrojtja e resurseve ujore ka rëndësi jetike për çdo shoqëri. Kosova për momentin nuk i plotëson kushtet e nevojshme në kuptim të furnizimit të pakufizuar me ujë, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza, ujitjes, menaxhimit të rrezikut nga përmytjet dhe erozioni, ndërsa që ndotja e pothuajse të gjithë lumenjve dhe ujërave nëntokësore i kontribuon degradimit çdo herë e më të madh të mjedisit jetësor dhe kërcënimit të cilësisë së jetës së qytetarëve.

Resurset ujore në Kosovë përfshijnë ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe burimet e ujit. Uji i pijes kryesisht sigurohet nga ujërat sipërfaqësore. Sa u përket lumenjve, ekzistojnë

pesë rrjedha kryesore të lumenjve: Drini i Bardhë (derdhet në Adriatik), Ibër (derdhet në Detin e Zi), Lepenci (derdhet në Egje), Morava e Binçes (derdhet në Detin e Zi) dhe lumi i Plavës (derdhet në Adriatik). Numri i liqeneve natyrore është i vogël, ndërsa janë ndërtuar 6 akumulime artificiale me qëllim të plotësimit të nevojës jo vetëm për ujë të pijshëm por edhe për nevoja të bujqësisë dhe industrisë. Akumulimi më i madh është liqeni i Gazivodës,<sup>95</sup> i krijuar në vitin 1977 me barikadimin e rrjedhës së sipërme të Ibrit në komunën e Zubin Potokut, me vëllim prej 390 milionë m<sup>3</sup> ujë.<sup>96</sup> Penda “Gazivodë” paraqet një nga pendat më të mëdha tokësore në Evropë, me gjatësi prej 460m dhe lartësi prej 107m. Përmes kanaleve, uji nga ky liqen silltet deri në Prishtinë dhe shfrytëzohet për furnizim dhe ftohje të turbinave në termocentralet e Obiliqit. Përveç kësaj, akumulime tjera artificiale në Kosovë janë liqenet e Badovcit, Radoniqit, Batllavës, Livoçit dhe Prilepnicës. Sistemi për përcjellje të ujërave sipërfaqësore ekziston por është i domosdoshëm modernizimi i të njëjtit.

Sa u përket ujërave nëntokësore, edhe ato janë të kufizuara për nga sasia dhe kryesisht gjenden në anën perëndimore të Kosovës, në të cilën edhe rezervat e ujërave sipërfaqësore janë më të mëdha se sa ato në anën lindore.<sup>97</sup> Një nga rekomandimet e Komisionit Evropian në Raportin e Progresit të Kosovës për vitin 2016 është që të fillohet sa më shpejtë që të jetë e mundur me identifikimin e resurseve nëntokësore dhe krijimin e sistemit për përcjellje të cilësisë së ujërave nëntokësore. Prandaj, duhet të bëhen përpjekje shtesë për të zgjidhur problemet e lartpërmendura me qëllim të përparimit në furnizimin me ujë të cilësisë së lartë për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Karakteristikat kryesore hidrologjike në Kosovë janë ndarja e pabarabartë dhe joadekuate e resurseve ujore, në krahasim me kërkesën. Ngjashëm i pabarabartë është edhe furnizimi me ujë në zonat urbane dhe rurale të Kosovës, ndërsa organet kompetente ende nuk po gjejnë zgjidhje adekuate për këtë problem. Vlerësohet se momentalisht 81.2% të popullatës së Kosovës është e lidhur me sisteme funksionale të ujësjellësit. Në zona urbane, ujësjellësi mbulon 100% të popullatës, ndërsa në zona rurale mbulueshmëria arrin 69,7%<sup>98</sup>. Banorët e viseve rurale që nuk janë të lidhur me ujësjellës më së shpeshti përdorin ujë të pakontrolluar nga pusët e tyre. Përveç kësaj, qasja në rrjet të kanalizimit përbën një nga problemet kryesore, posaçërisht në vise rurale. Nga popullata e gjithëmbarshme, 65% jetojnë në lagje me sisteme të kanalizimit, ndërsa vetëm 42% të popullatës rurale ka qasje në kanalizim.<sup>99</sup>

Në Kosovë funksionon një ndërmarrje publike qendrore – Ndërmarrja hidroekonomike “Ibër Lepenc”, infrastruktura e së cilës ndodhet në shtatë komuna: Zubin Potok, Mitrovicë, Vushtri, Obiliq, Fushë Kosovë, Prishtinë dhe Gllogoc. Kjo ndërmarrje multifunksionale furnizon me ujë të pijes disa ujësjellës në Kosovë dhe siguron ujë për ujitje të tokave

<sup>95</sup> Liqeni i Gazivodës është akumulim prej 380 miliona m<sup>3</sup> ujë, i gjatë 24 km, një pjesë më e vogël e sipërfaqes të së cilit gjendet në territorin e komunave Tutin dhe Novi Pazar të Serbisë e pjesa më e madhe në territorin e komunës Zubin Potok.

<sup>96</sup> Plani Hapësinor i Kosovës, Strategjia për Zhvillim Hapësinor 2010-2020, në faqen <http://bit.ly/2seK1BA>, f. 38

<sup>97</sup> Raporti për gjendjen e ujërave në Kosovë, 2015, Ministria Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në faqen <http://bit.ly/2snDB2e>, f. 30.

<sup>98</sup> Strategjia e Menaxhimit të Sistemeve Ujore Rurale, Nëntor 2014, në faqen <http://bit.ly/2sny2kc>, f. 21. Komunitat nga veriu i Kosovës nuk janë shtjelluar si rrjedhojë e mungesës së të dhënave të sakta.

<sup>99</sup> Studimi i Mbulueshmërisë dhe Vlerësimit të Sistemeve të Ujësjellësit dhe Kanalizimit në Kosovë, Zyra për Zvicëranë për Bashkëpunim në Kosovë, 2012, në faqen <http://bit.ly/2qGQDGZ>, f. 6.

bujqësore dhe stabilimenteve industriale (Trepça, Kosova B, Kosova A, Feronikeli) dhe për prodhim të energjisë elektrike.<sup>100</sup> Po ashtu, në periudhën 2002-2006 janë themeluar shtatë ndërmarrje të ujësjellësve rajonale dhe kanalizimit, si dhe dy ndërmarrje rajonale të ujitjes:

1. Kompania e Ujësjellësit Rajonal “Prishtina”, Prishtinë
2. Kompania e Ujësjellësit Rajonal “Hidroregjioni Jugor”, Prizren
3. Kompania e Ujësjellësit Rajonal “Hidrodrini”, Pejë
4. Kompania e Ujësjellësit Rajonal “Mitrovica”, Mitrovicë
5. Kompania e Ujësjellësit Rajonal “Radoniqi”, Gjakovë
6. Kompania e Ujësjellësit Rajonal “Hidromorava”, Gjiilan
7. Kompania e Ujësjellësit Rajonal “Bifurkacioni”, Ferizaj

Në mars të vitit 2017, si pjesë e Kompanisë së Ujësjellësit Rajonal Prishtina është hapur fabrika për përpunimin e ujit në Shkabaj të Prishtinës. Me ujë nga kjo fabrikë do të furnizohet qyteti i Prishtinës, por edhe gjashtë komunat tjera të lidhura me këtë ujësjellës rajonal. Mjetet për ndërtimin e kësaj fabrike janë ndarë nga fondet e Bashkimit Evropian (IPA) në vlerë prej 5 milionë eurosh, komuna e Prishtinës 5 milionë euro, Qeveria e Kosovës 5 milionë euro si dhe kredia e Bankës Gjermane për Zhvillim në vlerë prej 20 milionë eurosh.

Përveç ndërmarrjeve rajonale për ujësjellës dhe kanalizim, funksionojnë edhe dy ndërmarrje rajonale për ujitje:

1. Ndërmarrja rajonale e ujitjes Drini i Bardhë dhe
2. Ndërmarrja rajonale e ujitjes Radoniqi – Dukagjini

Me kalimin e viteve ka pësuar ndryshim të madh edhe sasia e nevojshme e ujit për ujitjen e tokave bujqësore. Në tabelën në vijim është paraqitur sasia e ujit të shfrytëzuar për këtë qëllim në periudhën mes 2002 dhe 2014:

**Tabela 5.2** Ujitja e tokave bujqësore në periudhën 2002-2014

| Viti  | 2014 | 2013 | 2012 | 2011 | 2010 | 2009 | 2008 | 2007 | 2006 | 2005 | 2004 | 2003 | 2002 |
|---|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| Ujë për ujitje<br>(milionë m <sup>3</sup> /vit) | 55   | 52   | 50   | 46   | 42   | 40   | 44   | 41   | 39   | 36   | 33   | 36   | 34   |

*Burimi:* Statistikat Ujore të Kosovës 2015

Ndërmarrjet rajonale për ujitje përballen me faktin se sistemet e ujitjes janë vjetërsuar dhe kanë humbur efikasitetin. Të hyrat që sigurohen nga to nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, e lere më investimet. Përveç kësaj, ekziston një numër i madh i sistemeve të ujitjes të ndërtuara në mënyrë jologjore, kryesisht si rrjedhojë e iniciativave të individëve apo grupeve lokale të bujqve.<sup>101</sup>

<sup>100</sup> <http://www.iber-lepenc.org/?page=3,1,22#.WPTxJfmLTIU>

<sup>101</sup> Strategjia për Ujërat e Kosovës, në faqen <http://bit.ly/2rbZrbf>, f. 104.

Në veri të Kosovës (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) ekzistojnë disa ndërmarrje publike të ujësjellësit që funksionojnë sipas sistemit të Republikës së Serbisë. Ndërmarrja “Ujësjellësi Ibër” me seli në Mitrovicën e Veriut është kompetent për sistemin e ujësjellësit në komunat e Mitrovicës së Veriut dhe Zveçanit. Këto dy komuna aktualisht furnizohen me ujë që sigurohet nga kompania e ujësjellësit Mitrovica përmes fabrikës së ujit që ndodhet në Shipol (komuna e Mitrovicës së Jugut). Komunat e Zubin Potokut dhe Leposaviqit kanë sisteme lokale të ujësjellësit, me të cilat menaxhojnë Ndërmarrja Publike Komonale “Ibër” nga Zubin Potoku dhe Ndërmarrja Publike Komonale “24 Nëntori” nga Leposaviqi. Me ndihmë të donatorëve në Leposaviq rishtas është ndërtuar fabrika për përpunimin e ujit, por ajo ende nuk është funksionale.

Me qëllim të zgjidhjes së problemeve të ujësjellësit, komunat e Zubin Potokut, Mitrovicës së Veriut dhe Zveçanit kanë marrë kredi nga bankat komerciale në Serbi për ndërtimin e ujësjellësit rajonal, i cili do të furnizonte këto komuna me ujë të pijes nga liqeni e Gazivodës. Vlera e gjithmbarshme e punimeve arrin mbi 10 milionë euro, ndërsa garancinë për këtë kredi e ka dhënë Qeveria e Republikës së Serbisë. Sipas projektit është themeluar ndërmarrja rajonale e ujësjellësit e cila do të menaxhojë me këtë sistem pas ndërtimit të tij.

Infrastruktura ekzistuese për furnizim të ujit në Kosovë është e pamjaftueshme për të plotësuar kërkesa për ujë të pijes, por edhe për ujë të nevojshëm për amvisëri, rekreacion e të ngjashme. Megjithatë, gjendja e infrastrukturës është e keqe dhe ndikon në efikasitet të ujësjellësit. Gypat e ujësjellësit janë kryesisht të vjetër, gjë që rezulton me rrjedhje të ujit e si rrjedhojë me efikasitet më të ulët dhe rrezik më të madh nga ndotja. Megjithatë, falë investimeve të donatorëve dhe ndërrimit të disa gypave të caktuar janë të dukshme përmirësimet në këtë drejtim.

Gjendja është shumë më e keqe kur flitet për infrastrukturën e grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve të kanalizimit, që është një nga ndotësit më të mëdhenj të resurseve ujore. Pjesa më e madhe e mbetjeve nga kanalizimi derdhet direkt në lumenj, ndërsa mungesa e stabilimenteve për përpunimin e ujërave të zeza ndikon tepër shumë në degradimin e mjedisit dhe shëndetin e njerëzve. Aktualisht ekziston vetëm një stabiliment për përpunim të ujërave të zeza në Skenderaj, i cili nuk është funksional për shkak të problemeve teknike dhe financiare. Stabilimente për trajtim të ujërave të zeza nuk ka as në veri të Kosovës, prandaj kanalizimi derdhet direkt në lumin Ibër ose në rrjedhat e tij. Në bazë të disa studimeve të fizibilitetit, vlerësohet se shpenzimet e gjithmbarshme për ndërtimin e stabilimenteve të tilla në tërë Kosovën do arrinin 517 milionë euro.<sup>102</sup> Sa i përket mbulueshmërisë me shërbime publike në grumbullimin e ujërave të zeza nga ana e kompanive rajonale të ujësjellësit dhe kanalizimit, në vitin 2013 është arritur mbulueshmëri prej 60% që është 4% më e gjerë se në vitin 2012.<sup>103</sup>

Menaxhimi i rrezikut nga përmytjet në Kosovë si proces gjendet në fazat fillestare. Nuk ekzistojnë planet të definuara dhe adekuate për menaxhim të rrezikut nga përmytjet, prandaj është e domosdoshme që të hartohen planet dhe definoohen masat për zvogëlim dhe shmangie të rrezikut. Vlerësimet preliminare të rrezikut nga përmytjet nuk implementohen, edhe pse

<sup>102</sup> Raporti për gjendjen e ujërave në Kosovë, 2015, Ministria Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në faqen <http://bit.ly/2snDB2e>, f. 90.

<sup>103</sup> Raporti për gjendjen e ujërave në Kosovë, 2015, Ministria Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në faqen <http://bit.ly/2snDB2e>, f. 88.

janë realizuar disa pilotprojekte më të vogla. Identifikimi i rrezikut nga përmbytjet është kryer për disa rrjedha të caktuara nën kornizat e projekteve konkrete, por nuk ekziston një metodologji unike e cila do të implementohej në të gjitha rrjedhat.

Viteve të kaluara vërehet rritja e investimeve në sektorin e ujërave, si nga donatorët ndërkombëtarë ashtu edhe nga Buxheti i Qeverisë së Kosovës. Investimet e Qeverisë së Kosovës kryesisht janë fokusuar në rregullimin e lumenjve dhe avancimin e infrastrukturës, ndërsa mjetet nga donatorët kanë qenë të orientuara në realizimin e studimeve të fizibilitetit për infrastrukturë të nevojshme dhe për trajtim të ujërave. Donatorët më të mëdhenj në sektorin e ujërave në Kosovë janë Zyra Zvicerane për Bashkëpunim, Bashkimi Evropian, GIZ, Banka Zhvillimore Gjermane, JICA, DANIDA, IOM, USAID, Qeveria e Luksemburgut, etj. Vlerësohet se nga viti 1999 në sektorin e ujërave janë investuar rreth 255 milionë euro, nga të cilat rreth 190 milionë në formë donacionesh.<sup>104</sup> Në kontekst të përafrimit me standardet e Bashkimit Evropian, vlerësohet se do të nevojiten së paku 60 milionë euro investime vjetore në dhjetë vitet e ardhshme, për ta afruar Kosovën me standardet përkatëse.<sup>105</sup>

#### 5.4 Ndotja e resurseve ujore

Rritja e popullatës, urbanizimi çdo herë në rritje, kërkesat e industrisë dhe bujqësisë dhe ndryshimet klimatike në masë të gjerë ndikojnë në rritje të kërkesës për ujë. Por, nuk guxon të neglizhohet ndikimi në karakteristikat biologjike, kimike dhe fizike të ujit, të cilat e ulin cilësinë e tij. Cilësia e ujit ka rol kyç në funksionet që uji ka për jetë e njeriut dhe ekosistemin në përgjithësi. Përdorimi i ujit të pijes, për pastrim dhe rekreacion ka si parakusht që ai të jetë pa ndotës biologjikë, fizikë apo kimikë. Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), në bashkëpunim me MMPH, ka përgatitur një raport të kadastrit të ndotësve të ujërave në Kosovë,<sup>106</sup> i cili identifikon 368 ndotës të ujit, nga të cilët 266 janë ndotës kolektivë,<sup>107</sup> ndërsa 102 ndotës individualë.<sup>108</sup>

Në regjionin e rrjedhës së Drinit të Bardhë janë regjistruar 154 ndotës, nga të cilët 99 kolektivë e 56 individualë. Në regjionin e rrjedhave të Ibrit, Lepencit dhe Moravës së Binqës janë identifikuar 214 ndotës. Vetëm në atë të Ibrit janë regjistruar 100 ndotës, nga të cilët 75 kolektivë e 25 individualë. Në rrjedhën e Moravës së Binqës dhe Lepencit ndodhen 24 sish.

Në tabelën në vijim është paraqitur numri i ndotësve kolektivë dhe individualë në rajonin e Mitrovicës.

<sup>104</sup> Raporti për gjendjen e ujërave në Kosovë, 2015, Ministria Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në faqen <http://bit.ly/2snDB2e>, f. 96.

<sup>105</sup> Kosova Veriore në vitin 2020 – Bërja e historive të ardhme, f. 58

<sup>106</sup> Raporti i Kadastrit të Ndotësve të Ujërave në Kosovë, REC, MMPH, në faqen <http://bit.ly/2rV6mGU>, f. 17.

<sup>107</sup> Sipas këtij projekti ndotës kolektivë janë të gjithë ndotësit apo lagjet që kanë mbi 50 ekonomi familjare dhe i kanë bashkërisht të organizuara kanalizimet apo gropat septike.

<sup>108</sup> Ndotës individualë janë operatorët që kanë potencial më të madh ndotës, si: industria, bujqësia, autombeturinat apo pastruesit e mëdhenj kimikë.

**Tabela 5.3** Ndotësit kolektivë dhe individualë në rajonin e Mitrovicës

| Regjioni        | Komuna      | Ndotës kolektivë | Ndotës individualë |
|-----------------|-------------|------------------|--------------------|
| Mitrovica       | Mitrovica   | 13               | 6                  |
|                 | Vushtrri    | 10               | 3                  |
|                 | Skenderaj   | 1                | 0                  |
|                 | Leposaviq   | 5                | 0                  |
|                 | Zveçan      | 3                | 0                  |
|                 | Zubin Potok | 7                | 0                  |
| <b>Gjithsej</b> |             | <b>39</b>        | <b>9</b>           |

*Burimi:* Raporti i kadastrit të ndotësve të ujërave në Kosovë: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Ndotësit kryesorë industrialë janë Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), kompleksi Feronikelit (prodhues i legurave të çelikut dhe nikelit), fabrika e cementit Sharrcem, si dhe komplekset minerare Trepça, Kishnica, etj. Kombinati xehetar-metalurgjik Trepça dikur ka qenë bosht i ekonomisë së Kosovës, ndërsa sot përbën një nga sfidat më të mëdha ekologjike. Gjatë kohës kur Trepça ka punuar me kapacitet të plotë, vlerësohet se në ujë ka derdhur sasi të mëdha të ndotësve: 150 tonë plumb, 300-900 tonë zink, 900 tonë fluor, etj.<sup>109</sup> Edhe pse pjesa më e madhe e stabilimenteve të Kombinatit Trepça është mbyllur, acidet e mbetura, copëzat e pluhurit, mënyra e pasigurt e funksionimit dhe deponitë e pa mirëmbajtura dhe jostabile paraqesin rrezik të përditshëm për ata që jetojnë në afërsi.

Përveç industrisë, bujqësia është një nga sektorët që më së shumti përdorë resurset ujore por edhe një nga ndotësit më të mëdhenj. Veprimtaria bujqësore në masë të gjerë ndikon në cilësinë e ujërave, veçanërisht kur kemi parasysh ndikimin e agrokimikateve (pesticideve, plehrave, etj.) të cilat treten nëpër lumenj dhe ujëra nëntokësore. Bujqit në mënyrë joadekuate dhe të pakontrolluar i shfrytëzojnë agrokimikatet me çka i kontribuojnë ndotjes së resurseve ujore.

Lumi më i ndotur në Kosovë është Sitnica, lum ky i gjatë 90m i cili derdhet në lumin Ibër. Në pjesën përreth lumit Sitnica veprimtaria më e zhvilluar është bujqësia.<sup>110</sup> Megjithatë, vlerësohet se ndikimi i veprimtarisë bujqësore në ujërat sipërfaqësore në Kosovë është më i ulët se sa në shtetet e BE-së,<sup>111</sup> që është e kuptueshme marrë parasysh faktin se bujqësia e Kosovës vazhdon të jetë pamjaftueshëm e zhvilluar. Sidoqoftë, me intensifikimin e bujqësisë

<sup>109</sup> Menaxhimi i mbeturinave industriale të Kombinatit Trepça, UNDP 2011, në faqen <http://bit.ly/2qBRNUF>, f. 9.

<sup>110</sup> Efektet e veprimtarisë industriale dhe bujqësore në cilësinë e ujërave të lumit Sitnicë, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Universiteti i Bujqësisë në Tiranë, Shqipëri, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, f. 1

<sup>111</sup> Raporti për gjendjen e ujërave në Kosovë, 2015, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në faqen <http://bit.ly/2snDB2e>, f. 89.

duhet të zhvillohen edhe masa efikase të monitorimit ekologjik të veprimtarisë bujqësore, me qëllim të zvogëlimit të rrezikut nga ndotja e mjedisit.

### 5.5 Përfundimet dhe rekomandimet

Megjithëse është krijuar struktura adekuate institucionale për të menaxhuar sektorin e ujërave në Kosovë, harmonizimi i akteve ligjore dhe nënligjore me rrjedhat ligjore në Bashkimin Evropian, si dhe miratimi i strategjisë kombëtare për ujërat mbeten disa prej prioriteteve kryesore. Problem përbën edhe furnizimi me ujë të pijes në zona urbane e rurale, për të cilin nuk ka indikacione se do të zgjidhet së shpejti.

Gjendja aktuale e ndotjes së resurseve ujore në Kosovë nuk jep shenja optimizmi, pa marrë parasysh hapat e ndërmarrë me qëllim të avancimit të mbrojtjes dhe shfrytëzimit racional të resurseve ujore. Numri i ndotësve është i lartë, ndërsa mungesa e një sistemi për monitorim të cilësisë së ujërave nëntokësore dhe vjetërsia e sistemit të monitorimit të ujërave sipërfaqësore përbëjnë disa prej problemeve më të shquara të këtij sektori. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet infrastrukturës ujore, para së gjithash stabilimenteve për përpunimin e ujërave të zeza, por edhe modernizimit të infrastrukturës ekzistuese të ujësjellësve dhe kanalizimeve.

Investimet e deritanishme në sektorin e ujërave nuk janë në nivel të neglizhueshëm, por për të arritur progres më i theksuar në përafrimin me BE-në, për furnizim adekuat dhe mbrojtje adekuate të resurseve ujore do të jenë të domosdoshme investime bindshëm më të mëdha. Në të ardhmen do të jenë të nevojshme edhe përpjekje shtesë për të reduktuar ndikimin negativ të ndotjes në mjedis dhe shëndet të njerëzve dhe për tu siguruar që resurset ujore do të shfrytëzohen për zhvillim socioekonomik të Kosovës.

Në bazë të kësaj, mund të nxirren rekomandimet në vijim:

- Duhet të bëhen përpjekje shtesë për të ngritur efikasitetin e furnizimit të ujit në Kosovë, si me ujë të pijes ashtu edhe me ujëra teknike (në veçanti për ujitje). Posaçërisht duhet të punohet në forcimin e kapaciteteve të ndërmarrjeve të ujitjes, ndërsa zgjidhje mund të jetë edhe privatizimi i këtyre ndërmarrjeve, krijimi i partneriteteve publiko-private apo dhënie a koncesioneve. Në menaxhimin e ndërmarrjeve të ujitjes duhet të përfshihen bujq, të organizuar në shoqata apo kooperativa.
- Në veri të Kosovës duhet të kryhen punimet në ujësjellësin rajonal i cili do të mundësojë furnizimin me ujë të pijes për komunat e Zubin Potokut, Zveçanit dhe Mitrovicës së Veriut. Gjithashtu është me rëndësi që të krijohen kushte për bashkëpunim mes ndërmarrjes rajonale e cila do të menaxhojë këtë sistem dhe Kompanisë së Ujësjellësit Rajonal Mitrovica nga ana jugore e Mitrovicës.
- Duhet të bëhen përpjekje shtesë për të mbrojtur rrjedhat e ujit nga ujërat e zeza dhe deponitë ilegale të mbeturinave të cilat shpesh ndodhen në afërsi të rrjedhave të lumenjve. Në këtë drejtim është e domosdoshme ndihma nga Bashkimi Evropian, organizatat bilaterale e ndërkombëtare, si dhe institucioneve financiare



ndërkombëtare, si në kuptim të hartimit të strategjisë dhe planit të veprimit ashtu edhe në financimin e infrastrukturës së nevojshme.

- Duhet të punohet vazhdimisht në ngritjen e vetëdijes publike lidhur me rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, në veçanti mbrojtjen e ujërave dhe rrjedhave të lumenjve. Në këtë drejtim është i domosdoshëm bashkëpunimi me qarqe më të gjera shoqërore, nga institucionet arsimore (shkollat, institucionet parashkollore, etj.), deri tek organizatat e shoqërisë civile dhe entitetet ekonomike.

# Ujërat në Kosovë

## Rruga drejt BE-së

Pajtueshmëria me direktivat kryesore të Bashkimit Evropian për sektorin e ujërave është nën 50%

Nga viti 1999 për rregullimin e lumenjve, avancimin e infrastrukturës dhe shërbimeve të furnizimit të ujit janë investuar rreth 255 milionë euro, nga të cilat rreth 190 kanë qenë donacione

Vlerësohet se sektorit të ujërave i nevojiten së paku 60 milionë euro investime në vit për gjatë dhjetë viteve të ardhshme (veçanërisht në infrastrukturë)



## Ndotja e resurseve ujore



368 ndotës



Industria dhe bujqësia janë mes ndotësve më të mëdhenj të resurseve ujore në Kosovë

Janë identifikuar **368** ndotës të ujit, nga të cilët **266** kolektivë dhe **102** individualë

Në Kosovë pothuajse nuk ekzistojnë fare stabilimente për pastrim të ujërave të zeza, kështu që të gjitha mbeturinat e kanalizimit përfundojnë në rrjedha ujore pa kurrfarë trajtimi paraprak

## Karakteristikat hidrologjike në Kosovë

**81,2%** e banorëve të Kosovës shfrytëzojnë shërbimet publike të furnizimit me ujë

**65%** e banorëve jeton në vendbanime me sistem të kanalizimit

Mjediset rurale në Kosovë → **69.7%** kanë qasje në rrjetin e ujësjellësit  
→ **42%** kanë qasje në kanalizim

Mjediset urbane përballen me furnizim të parregullt të ujit të pijes, posaçërisht gjatë muajve të verës



## PËRFUNDIMI

Në bazë të të gjitha hulumtimeve, debateve publike dhe konferencave mund të nxjerrim disa përfundime që janë karakteristike për fushën e mbrojtjes së mjedisit, pa marrë parasysh temën.

Fillimisht duhet të theksohet se mbrojtja e mjedisit nuk paraqet temë politikisht të rëndësishme në Kosovë, e në të njëjtën kohë nuk ekziston ndonjë parti politike apo lëvizje që merret me këtë tematikë. Mjedisi përmendet kohëpaskohe në paraqitjet publike të përfaqësuesve të pushtetit, veçanërisht në konferencat të cilat organizohen në këtë temë nga organizatat ndërkombëtare apo në rast të situatave ekstreme si ndotja e ajrit në Obiliq e Prishtinë, përmytjet apo ndotjet e lumenjve. Megjithatë, edhe pse ka përkrahje deklarative, domeni i këtyre paraqitjeve publike është përgjithësisht i kufizuar.

Vetëdija e qytetarëve në lidhje me mbrojtjen e mjedisit është kryesisht në nivel të ulët, prandaj ka hapësirë të gjerë për veprim në këtë fushë. Aktivitetet e deritanishme të organizatave joqeveritare dhe vullnetare kryesisht janë fokusuar në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve, në veçanti të fëmijëve mbi mjedisin e shëndoshë dhe rëndësinë e aksioneve për pastrim të deponive të egra. Megjithatë, të gjitha këto aktivitete janë të karakterit të kufizuar, sepse për të siguruar rezultate më të mira duhet t'i qasemi zgjidhjes së problemeve në mënyrë sistematike si dhe të sigurojmë përkrahjen e organeve përgjegjëse.

Kosova përpiket të kapë hapin në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Në lidhje me këtë, është duke u zhvilluar procesi i harmonizimit të legjislacionit vendor me dispozitat dhe konventat evropiane dhe botërore. Si rrjedhojë janë miratuar disa ligje, akte nënligjore dhe strategji, ndërsa është formuar edhe rrjeti i institucioneve që implementon apo përcjellë impleentimin e rregullativës në nivel qendror dhe lokal. Megjithatë, ekzistojnë edhe shumë sfida për implementimin e rregullativës ligjore, si në kuptim të mungesës së mjeteve për realizim të investimeve publike ashtu edhe në atë të funksionimit operativ të institucioneve. Implementimi i ligjeve gjithashtu përbën problem të madh, sikur edhe puna e organeve të drejtësisë si rezultat i së cilës politika ndëshkimore nuk po i jep rezultatet e dëshiruara.

Sfidat në impleentimin e ligjeve janë posaçërisht të theksuara në veri të Kosovës, ku problemi është para së gjithash politik e jo funksional. Në fakt, në veri të Kosovës është i pranishëm dualiteti në implementim të ligjeve të Serbisë dhe Kosovës, gjë që shpesh rezulton me mosimplementim të ligjeve fare. Kjo përbën problem kur është në pyetje implementimi i

Në diskursin politik në Prishtinë dominojnë temat që ndërlidhen me ndërtimin e shtetësisë së Kosovës, përfshirë integrimin politik të komunave me shumicë serbe të veriut të Kosovës dhe dialogun me Beogradin. Shpesh në agjendë gjejnë vend edhe tema që ndërlidhen me integrimet evropiane, ndërsa tek opozita kryesisht dominon tema e korrupsionit. Në komunat e veriut të Kosovës dhe në mesin e politikanëve serbë dominojnë temat që ndërlidhen me marrëveshjen e Brukselit, e në veçanti me formimin e Komunitetit/Asociacionit të komunave me shumicë serbe.

dispozitave sanksionuese ndaj ndotësve, ndërsa situata ndërlikohet edhe më tej nga fakti në veri të Kosovës nuk ekzistojnë organe funksionale gjyqësore.

Sektori privat kryesisht nuk e ka konsideruar angazhimin më aktiv në punë që lidhen me mjedisin si mundësi zhvillimi. Në komunat e Kosovës sektori privat kryesisht angazhohet përmes koncesioneve për punë në grumbullimin, depozitimin dhe tregtimin e mbeturinave të ngurta, ndërsa prania e subjekteve private në fushat tjera të mbrojtjes së mjedisit është në masë të neglizhueshme. Në veri të Kosovës punët në grumbullimin e mbeturinave komunale i kryejnë ndërmarrjet publike komunale të themeluara para luftës, e të cilat nuk janë reformuar e si të tilla nuk njihen nga autoritetet qendrore të Kosovës.

Organizatave ndërkombëtare janë nxitësi më i madh i ndryshimeve në fushën e mjedisit. Mes tyre dallohet Bashkimi Evropian, i cili përmes Zyrës në Kosovë përpiket të ndihmojë në nxjerrjen dhe implementimin e rregullativës ligjore në pajtim me konventat ndërkombëtare dhe evropiane, si dhe në ndërtimin e infrastrukturës së domosdoshme. Mes organizatave tjera janë edhe GIZ, Sida, ADA, Qeveria e Finlandës, USAID, DANIDA, dhe Banka Botërore, të cilat me programet dhe projektet e veta i kontribuojnë avancimit të cilësisë së mjedisit në Kosovë.

**INSTITUTI PËR ZHVILLIMIN  
EKONOMIK TERRITORIAL (INTER)**  
THE NORTH CITY  
ÇIKA JOVINA BB, II/9  
MITROVICË VERIORE  
OFFICE@REGIONALNIRAZVOJ.ORG  
WWW.REGIONALNIRAZVOJ.ORG

